



## Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Konzervimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Përdorimit të Tokës në Dragash



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

### Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm

# Korniza për zhvillim rural të balancuar dhe gjithpërfshirës të Komunës së Dragashit Kosovë

## Vëllimi III: Vlerësimi

**Peter Bank**

**Florian Bemmerlein-Lux**

**Ergin Hajredini**

**Ismail Gagica**

Me kontributin e Prof. Dr. Behxhet Mustafa – ekolog, Prof. Fadil Millaku- biolog, Dr. Halil Ibrahim - ekolog; Dr. Achim Milbradt – biolog, Michael Voit- planifikues i zhvillimit rural, Prof. Xhevdet Elezi – shkenctar i tokës– agronom, Arneni-Kompani Kombëtare Këshilluese për Pyjet, NGO Finches – vrojtues të zogjëve, Todd Wassel – specialist i turizmit, Kaltrina Salihu – zyrtare e komunitetit, Bashkim Susuri – gazetar dhe staf i projektit, Bardh Xerxa – ekolog, Ajhan Hadzija – koordinator i turizmit, dhe Grupi punues i komunës së Dragashit dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH Programi i Zhvillimit Ekonomik Rural.

**Menaxhues Projekti**

**Maria Elena Zuniga Barrientos**

**Dragash, Kosovë**

**mars 2013**



## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| Përmbajtja.....   | 2  |
| 1. Hartat e vlerësimit.....   | 5  |
| 1.1. Vlerësimi i biodiversitetit (A1) .....   | 6  |
| 1.1.1. Vlerësimi i vegjetacionit dhe florës (A1.1) .....                                      | 6  |
| 1.1.2. Vlerësimi i biodiversitetit- fauna .....   | 9  |
| 1.2. Parkut Kombëtar Sharri (A2) .....  | 12 |
| 1.3. Vlerësimi i burimeve të ujit.....  | 17 |
| 1.3.1. Regjenerimi i ujit, kërcënimi dhe kualiteti(A3.1).....                                 | 17 |
| 1.3.2. Furnizimi me ujë dhe kërcënimet (A3.2).....  | 20 |
| 1.4. Verësimi i rreziqeve natyrore (A4) .....   | 23 |
| 1.4.1. Rreziku nga erozioni (A4.1) .....  | 23 |
| 1.4.1. Rreziku nga orteqet (A4.2) .....   | 26 |
| 1.4.2. Zonat e rrezikuara nga rrëshqitja e dheut, gurëve dhe zonat e prira për përmytje ..... | 29 |
| 1.5. Vlerësimi i pyllit dhe bujqësisë (A5).....   | 31 |
| 1.5.1. Gjendja e pyjeve (A5.1) .....  | 31 |
| 1.5.2. Funkcionet e pyllit (A5.2) .....   | 34 |
| 1.5.3. Kapaciteti prodhues i tokës (A5.3).....  | 37 |
| 1.5.4. Bagëtia dhe përshtatshmëria për të lashta (A5.4) .....                                 | 39 |
| 1.6. Vlerësimi i mbeturinave të ngurta (A6) .....   | 41 |
| 1.7. Vlerësimi i potencialit për trashëgimi kulturore dhe turizëm (A7) .....                  | 44 |
| 1.8. Vlerësimi i shëndetit, shërbimeve mjekësore dhe mbrojtjes civile (A8) .....              | 47 |
| 1.9. Vlerësimi i arsimit (A9).....  | 50 |
| 1.10. Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës, dhe energjisë (A10) .....                       | 52 |
| 1.10.1. Rrugët dhe Transporti (A10.1).....  | 54 |
| 1.10.2. Energjia (A10.2).....   | 57 |
| 1.10.3. Bizneset (A10.3) .....  | 60 |
| 2. Aneks.....   | 63 |
| 2.1. Vlerësimi i kualitetit të ujit .....   | 63 |
| 2.2. Modeli i rrezikut nga erozioni .....   | 70 |
| 2.3. Modeli për analizë të rrezikut nga orteqet .....   | 73 |
| 2.4. Modeli për rrezikun e rrëshqitjeve të tokës.....   | 74 |
| 2.5. Kriteret e vlerësimit për funksionet e pyjeve.....                                       | 75 |
| 2.6. Përshtatshmëria e tokave dhe rekomandimet për përdorim bujqësorë .....                   | 76 |
| 2.7. Shpërndarja e konsumit të energjisë elektrike .....                                      | 81 |



## Lista e tabelave

|   |    |
|---|----|
| Tabela1-1: Lista e hartave të vlerësimit .....  | 5  |
| Tabela1-2: Zona dhe përqindja e llojeve të mjedisit në hartë, të cilat janë të mbrojtura sipas Direktivës së BE për Mjedisin-Florën dhe Faunën .....                          | 6  |
| Tabela1-3: Zona dhe përqindja e llojeve të vegjetacionit /përdorimi i tokës me potencial të lartë për biodiversitet bimor.....  | 7  |
| Tabela1-4: Numri i llojeve të rëndësishme të bimëve .....   | 7  |
| Tabela1-5: Numri i kafshëve i regjistruar në Komunë gjatë studimeve 2011/12.....  | 9  |
| Tabela1-6: Zonat e rëndësishme për regjenerimin e ujit.....   | 18 |
| Tabela1-7: Mos pajtueshmëria e kualitetit të ujit në rezervuar.....   | 20 |
| Tabela1-8: Rrugët e ekspozuara ndaj rreziqeve të rrëshqitjes së tokës dhe shkëmbinjëve.....   | 29 |
| Tabela1-9: Të hyrat nga prerja e pyjeve në sektorin publik/privat .....   | 31 |
| Tabela1-10: Mundësitë e punës në hollësim dhe pastrim.....  | 31 |
| Tabela1-11: Klasifimi i funksioneve të pyllit.....  | 34 |
| Tabela1-12: Total i mbledhur i mbeturinave në 2008 (ton) .....  | 42 |
| Tabela1-13: Matriksi i vlerësimit të trashëgimisë kulturore .....   | 45 |
| Tabela1-14: Zonat kryesore të trashëgimisë kulturore në komunën e Dragashit .....   | 45 |
| Tabela1-15: Modeli me furnizimin me staf dhe deficitet në shërbimet mjekësore .....   | 47 |
| Tabela1-16: Frekuentimet për shërbime mjekësore.....  | 48 |
| Tabela 1-17: funksionet e zonave të urbanizuara në terme të konceptit qendër sipas infrastrukturës egzistuese dhe nevojat zhvillimore të tyre (funksioni i themelimit) k..... | 53 |
| Tabela 1-18: Projektet rrugore të propozuara dhe vlerësuara .....   | 54 |
| Tabela1-19: Numri i bizneseve të regjistruaradhe nëpunësit sipasfshatit, Dragash .....  | 61 |
| Tabela 2-1: kualiteti i ujit bazuar në vlerat e indeksit biotik (Hilsenhoff, 1988) .....  | 63 |
| Tabela 2-2: Tabela shpjeguese e vlerësimit fizik të habitateve.....   | 63 |
| Tabela 2-3: Vlerësimi i ujit për pikat e huluntuara. ....   | 64 |
| Tabla 2-4: Rezultatet e kualitetit të ujit në rezervaret e 35 fshatrave në komunën e Dragashi t .....   | 66 |
| Tabela 2-5: Rezultatet analizave kimike të kualitetit të ujit (Instituti Hidro-meteorologjik i Kosovës 2012) .....  | 68 |
| Tabela 2-6: llojet pedologjike të tokave në komunën Dragashit bazuar në klasat e pjellorisë dhe grupet e përshtatshmërisë për prodhimtari bimore.....                         | 77 |
| Tabela 2-7: klasat e përshtatshmërisë dhe niveli i shfrytëzimit për kulturat e caktuara, bazuar në mënyrën e kultivimit dhe nivelin e makinerisë .....                        | 78 |
| Tabela 2-8: Max/min konsumi i energjisë për 2010 në komunën e Dragashit (të dhënat: bazuar në të dhënat zyrtare nga KEK 2012) .....   | 81 |

## Lista e figurave

|   |    |
|---|----|
| Figura1-1: Vegjetacioni dhe flora (A1.1).....   | 8  |
| Figura1-2: Fauna (A1.2) .....   | 11 |
| Figura1-3:Parku Kombëtar “Sharri” kufiri sipas Ligjit (Republika e Kosovës 2012) .....                                  | 12 |
| Figura1-4: Zona brenda dhe jashtë Parkut të planifikuar Kombëtar “Sharri” në Komunën e Dragashit                        | 13 |
| Figura1-5: Struktura e pronësisë brenda dhe jashtë Parkut të planifikuar Kombëtar “Sharri” në Komunën e Dragashit ..... | 14 |
| Figura1-6: Struktura e pronësisë brenda Parkut Kombëtar “Sharri” në Komunën e Dragashit (A2.1) ...                      | 15 |
| Figura1-7: Harta topografike – Parku Kombëtar “Sharri” në Komunën e Dragashit (A2.2) .....                              | 16 |
| Figura1-8: Vlerësimi i burimeve të ujit - regjenerimi, kërcënimet dhe kualiteti (A3.1) .....                            | 19 |
| Figura1-9: Vlerësimi i furnizimit me ujë (A3.2) .....   | 22 |



|   |    |
|---|----|
| Figura1-10: Rreziku i erozionit të tokës në klasat e ndryshme të lartësisë .....                        | 24 |
| Figura1-11: Rreziku nga erozioni i tokës në zonat kadastrale të komunës së Dragashit .....              | 24 |
| Figura1-12: Vlerësimi i rrezikut nga erozioni (A4.1) .....  | 25 |
| Figura1-13: Zonat e rrezikuara nga orteqet brenda Komunës .....   | 27 |
| Figura1-14: Zonat me rrezik nga orteqet brenda distancës 300m nga vendbanimet .....                     | 27 |
| Figura1-15: Vlerësimi i rrezikut nga orteqet (A4.2).....  | 28 |
| Figura1-16: Vlerësimi i rrezikut të rrëshqitjes së tokës dhe zonave të prira për përmbytje (A4.3) ..... | 30 |
| Figura1-17: Situtata e pronësisë në pyjet e Dragashit (në ha).....                                      | 32 |
| Figura1-18: Klasat e vjetërsisë në pyjet e Dragashit (në ha) .....                                      | 32 |
| Figure 1-19: Kërkesat specifike të menaxhimit në pyjet e Dragashit (në ha).....                         | 32 |
| Figura1-20: Vlerësimi i gjendjes së pyjeve (A5.1) .....   | 33 |
| Figura1-21: Zona e pyllit e dedikuar për funksione të ndryshme (në ha).....                             | 35 |
| Figura1-22: Vlerësimi i funksioneve të pyllit (A5.2) .....  | 36 |
| Figura1-23: Përshtatshmëria e tokave (në ha).....   | 37 |
| Figura1-24: Vlerësimi i kapacitetit prodhues të tokës (A5.3).....                                       | 38 |
| Figura1-25: Vlerësimi i bagëtisë dhe përshtatshmëria për të lashta (A5.4) .....                         | 40 |
| Figura1-26: Vlerësimi i mbeturinave të ngurta (A6).....   | 43 |
| Figura1-27: Vlerësimi i potencialit të trashëgimisë kulturore dhe turizimit (A7) .....                  | 46 |
| Figura1-28: Vlerësimi i shëndetit, shërbimeve mjekësore dhe mbrojtjes civile (A8) .....                 | 49 |
| Figura1-29: Vlerësimi i arsimit (A9) .....  | 51 |
| Figura 1-30: Funksionet e vendbanimeve .....  | 52 |
| Figura 1-31: Vlerësimi i rrugëve dhe transportit (A10.1) .....  | 56 |
| Figura 1-32: Vlerësimi i Energjisë (A10.2).....   | 59 |
| Figura 1-33: Bizneset e regjistruara në Dragash sipas sektorit .....                                    | 61 |
| Figura 1-34: Vlerësimi i bizneseve (A10.3) .....  | 62 |
| Figura 2-1: Korelacioni ndërmjet pjerrtësisë dhe rrezikut nga orteqët .....                             | 73 |





## 1. Hartat e vlerësimit

Hartat e hapit 2 tregojnë rezultatet e një procesi të vlerësimit për fushat kyçe. Ato përshkruajnë zonat me burime potenciale apo ato me burime të ndjeshme. Në mënyrë specifike kanë të bëjnë me pyetjet si më poshtë:

- Cilat janë kushtet e tanishme të burimeve?
- Cilat janë problemet dhe kufizimet ekzistuese dhe cilat janë vendodhjet apo lokacionet më me urgjencë?
- Sa të ndjeshme janë këto burime kundrejt ndikimeve të pafavorshme apo kur janë ato të shfrytëzuara?
- Cilat janë mundësitë e zhvillimit ende të mundura dhe ku?

Skema e sfidave, potencialet dhe problemet e zhvillimit janë të dhëna për hapat e ardhshëm, harta udhëzuese si dhe janë bazë strategjike për Planin Komunal të Zhvillimit.

Tabela1-1: Lista e hartave të vlerësimit

- A1 Vlerësimi i biodiversitetit**
  - A1.1 Vlerësimi i biodiversitetit – vegjetacioni dhe flora
  - A1.2 Vlerësimi i biodiversitetit – fauna
- A2 Zgjerimi i Parkut kombëtar Mali Sharr**
  - A2.1 Parku Kombëtar Mali Sharr–struktura e pronësisë
  - A2.2 Parku Kombëtar Mali Sharr–harta topografike
- A3 Vlerësimi i burimeve ujore - regjenerimi, kërcënimet, dhe kualiteti**
- A4 Vlerësimi i rreziqeve natyrore**
  - A4.1 Vlerësimi i rreziqeve natyrore –rreziku nga erozioni
  - A4.2 Vlerësimi i rreziqeve natyrore–rreziku nga orteqet e borës
  - A4.3 Vlerësimi i rreziqeve natyrore –rreshqitja e tokës dhe zonat me rrezik nga përmytjet
- A5 Vlerësimi i bujqësisë dhe pyjeve**
  - A5.1 Vlerësimi i pyjeve dhe bujqësisë –gjendja e pyjeve
  - A5.2 Vlerësimi i pyjeve dhe bujqësisë –funksionet e pyjeve
  - A5.3 Vlerësimi i pyjeve dhe bujqësisë–kapaciteti prodhues i tokave
  - A5.4 Vlerësimi i pyjeve dhe bujqësisë–bagëtia dhe përshtatshmëria për bimë
- A6 Vlerësimi i mbeturinave të ngurta**
- A7 Vlerësimi i trashëgimisë kulturore dhe potencialit turistik**
- A8 Vlerësimi i shëndetësisë, shërbimeve mjekësore dhe mbrotjes civile**
- A9 Vlerësimi i edukimit**
- A10 Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës dhe energjisë**
  - A10.1 Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës dhe energjisë– rrugët dhe transportimi
  - A10.2 Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës dhe energjisë– energjia
  - A10.3 Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës dhe energjisë– bizneset



## 1.1. Vlerësimi i biodiversitetit (A1)

### 1.1.1. Vlerësimi i vegjetacionit dhe florës (A1.1)

#### Përmbajtja e hartës:

Mjediset ekologjikisht të rëndësishme dhe llojet e bimëve (në prapavijë përdorimi i tokës është përdorur). Në detaje:

- Harta e vegjetacionit që është e përmendur në Aneksin 1 të Mjedisit Evropian (shih vëllimin II të AZHQ, seksioni 2.8, Tabela 12: Bashkësitë bimore të Dragashit të listuara në Aneksin I të Direktivës së BE-së për Mjedisin (EU 2007)
- Zonat specifike me potencial të lartë për biodiversitet bimor (pyjet cungishte, pyjet e tjera të vjetra me regjenerim natyror, zonat me vegjetacion të rrallë dhe shëmbinj të maleve të larta, si dhe ligatinat)
- Habitatet me vlerësim të bimëve të observuara me kategoritë e tyre mbrojtëse sipas studimeve të fundit në Dragash dhe në terma të konfigurimeve ndërkombëtare. Pikat e specieve përfshijnë ato që janë
  - Në njërin nga anekset e BE
  - Kategoritë e IUCN
  - Në disa tekste të Kosovës me kategori mbrojtura
  - Endemike (Kosovë, Balkan, Europë JQ)

#### Porositë kryesore:

Harta thekson pozitën ekzistuese (raritetin) kryesisht të pyjeve, tokave me vegjetacion natyror dhe ligatinoreve. Ajo lejon definimin e zonave potenciale të mbrojtura të cilat kërkojnë mbrojtje në mënyrë që të ruhen funksionet dhe shërbimet e tyre ekologjike sipas Ligjit të Mbrojtjes së Natyrës (i.e. rezervat strikt natyror, zonat speciale – Zonat e Veçanta të Mbrojtjes ZVM dhe Zonat e Veçanta të Ruajtjes ZVR, monumentet natyrore dhe peizazhet e mbrojtura) dhe zonimin e Parkut Kombëtar si pjesë e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar.

Modeli i hartës tregon qartë që shumica e zonave të veçanta ekologjike janë përbrenda Parkut Kombëtar Mali Sharr. Modeli konfirmon gjetjet (dhe shton detaje të konsiderueshme) në Identifikimin Preliminar të Natura 2000 Hapësirat në Kosovë (Mustafa et al. 2009).

Pyjet cungishte dhe kullotat e gjera si dhe livadhet e thata kanë gjithashtu një vlerë të lartë të biodiversitetit. Megjithatë, këto lloje të vegjetacionit varen nga menaxhimi (tradicional) i përdorimit të tokës.

Vegjetacioni dhe burimet floristike janë pjesë e informacionit për një strategji gjithëpërfshirëse të konservimit dhe do të kombinohet me vlerësimin e faunës dhe funksionet ekologjike të pyjeve për një udhëzues të përgjithshëm për konservimin e natyrës.

Definimi i llojeve të ndryshme të mbrojtura sipas Ligjit për Mbrojtje të Natyrës dhe zonimi i Parkut Kombëtar Malet e Sharrit mund të bazohen në këtë vlerësim.

Tabela 1-2: Zona dhe përqindja e llojeve të mjedisit në hartë, të cilat janë të mbrojtura sipas Direktivës së BE për Mjedisin-Florën dhe Faunën

| Vegjetacioni                            | Llojet e mjedisve të mbrojtura sipas Direktivës së BE për Mjedisin – Florën dhe Faunën |                                   |  | Totali nëha |
|---|--|-----------------------------------|--|-------------|
|   | Aneksi I   | Aneksi I* (Mjediset me prioritet) |  |             |
| Pyjet                                   | 2.933,9  | 397,1                             |  | 3.331,1     |
| <i>Në % të Komunës</i>                  | 6,7%   | 0,9%                              |  | 7,6%        |
| Tokat me barë                           | 1.483,8  | 13,9                              |  | 1.497,7     |
| <i>Në % të Komunës</i>                  | 3,4%   | 0,0%                              |  | 3,4%        |
| Kullotat                                | 24,7   | 611,3                             |  | 636,0       |
| <i>Në % të Komunës</i>                  | 0,1%   | 1,4%                              |  | 1,5%        |
| Zonat shkëmbore                         | 597,7  | 9,1                               |  | 606,9       |
| <i>Në % të Komunës</i>                  | 1,4%   | 0,0%                              |  | 1,4%        |
| Shkurret dhe/apo vegjetacioni barishtor | 107,5  |                                   |  | 107,5       |



|                               |                |                |                |
|-------------------------------|----------------|----------------|----------------|
| <i>Në % të Komunës</i>        | 0,2%           | 0,0%           | 0,2%           |
| Lingatinoret, Trupat ujore    | 66,5           |                | 66,5           |
| <i>Në % të Komunës</i>        | 0,2%           | 0,0%           | 0,2%           |
| <b>Zona totale e përshirë</b> | <b>5.214,1</b> | <b>1.031,4</b> | <b>6.245,6</b> |
| <i>Në % të Komunës</i>        | 12,0%          | 2,4%           | 14,3%          |

Tabela1-3: Zona dhe përqindja e llojeve të vegjetacionit /përdorimi i tokës me potencial të lartë për biodiversitet bimor

| Zonat specifike me potencial të lartë për biodiversitet bimor | Sipërfaqja jashtë llojeve të mjediseve të listuara në Aneksin I Direktiva e BE për Mjedisin – Florën dhe Faunën (në ha) | Në% të teritorit të Dragashit |
|---|---|-------------------------------|
| Pyjet me regjenerim natyror                                   | 1.023,4   | 2,3%                          |
| Pyjet cungishte dhe tokat me shkurre                          | 4.785,2   | 11,0%                         |
| Vegjetacioni gjysmë natyror i hapur                           | 17.071,2  | 39,2%                         |
| Të karakterizuara nga shkëmbijtë dhe zhavori                  | 694,6   | 1,6%                          |
| <b>Zona totale me potencial të lartë</b>                      | <b>23.574,5</b>   | <b>54,1%</b>                  |

Tabela1-4: Numri i llojeve të rëndësishme të bimëve

| Lista e referencave   | Nr. i llojeve të gjetura në teritorin e Dragashit/ |
|---|--|
| Lista e kuqe të IUCN (kategoritë afër kërcënimit apo të lëndueshme) | 2  |
| Direktiva e BE për Mjedisin – Florën dhe Faunën – Aneksi II         | 4  |
| Direktiva e BE për Mjedisin – Florën dhe Faunën – Aneksi v          | 2  |
| Të rekomanduara për Listën e ardhme të Kuqe të Kosovës              | 119  |
| <b>Nr. Total i llojeve të identifikuar gjatë punës në teren</b>     | <b>438</b>   |

## Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Mustafa B. 2011 dhe 2012, Armeni 2011, Millaku F. et al. 2011, Mustafa B. dhe H. Ibrahim 2009, Pierre Galland et al. 2010, EU 2007, Mustafa B. et al. 2009

## Sygerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

### Kufizimet:

Hulumtimet sistematike përfshinë vetëm një pjesë të Komunës me fokus në rajonin subalpin dhe alpin. Informatat hapërsinore për llojet e vegjetacionit (Rexhepi 1994) janë humbur gjatë luftës. Pavarësisht nga nevoja për hulumtime shkencore në të gjithë Komunën, gjetjet janë të mjaftueshme për të theksuar biodiversitetin e jashtëzakonshëm të kësaj pjese të zingjirit malor të Sharrit.

Për një koncept të mbrojtjes së ambientit të të gjithë komunës, veqanërisht për një plan menaxhimi për Parkun Kombëtar, një hartë e detajuar dhe complete e vegjetacionit (shkalla 1:25.000) do të kontribuonte me më shumë detaje për popullatat dhe shpërndarjen e tyre.







### 1.1.2. Vlerësimi i biodiversitetit- fauna

#### Përmbajtja e hartës:

Harta shqyrton shpërndarjen e kafshëve me vlerësim të kategorisë së mbrojtjes (endemizmin, rarishtin) sipas studimeve të fundit në Dragash dhe në terma të konfigurimit ndërkomëtar.

- Habitatet dhe korridoret ekologjike të ariut, rrëqebullit dhe dhisë së egër
- Zogjtë, insektet ujore, fluturat
- Llojet tjera (nuk ka inventarizim sistematik)
- Zonat me diversitet strukturor të përshtatshme për njëbiodiversitet të lartë të faunës si livadhe ekstensive në nivelin subalpin dhe alpin të përshtatshme për flutura dhe insekte tjera, zonat për specie të specializuara si rrëpirat dhe formacionet shkëmbore, dhe si diversiteti strukturor i lartë si pyjet me shumë shtresa dhe/apo tokat e hapura me gardhe, drunjtë e vetmuar dhe tarracat.

#### Porositë kryesore:

Rreth 94% e komunës siguron habitat për gjitarë, shpendë dhe flutura sipas Direktivës Evropiane të Habitaveve (përfshirë edhe Direktivën për Zogjtë– EU 2007 dhe 2009). Përveç mjediseve alpine për dhinë e egër, mjedisi subalpin, pyjet e larta malore dhe ekotoni i tranzicionit nga pyjet në zonat me barë janë korridore për rrëqebullin, ariun dhe ujkun, duke lidhur kështu vargmalet e Parkut Kombëtar Mali Sharr me malet e Maqedonisë dhe Shqipërisë. Kjo konfirmon gjetjet (dhe shton detaje të konsiderueshme) të Identifikimit Preliminar të Lokacioneve të Natura 2000 në Kosovë (Mustafa et al. 2009).

Burimet e faunës janë pjesë e informacionit për Parkun Kombëtar dhe definimin në të ardhmën të zonave të ndryshme të mbrojtura sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (rezervat strikt natyror, zonat speciale– ZVM dhe ZVR), monumentet e natyrës dhe peizazhet e mbrojtura. Korridoret ekologjike luajnë një rol të rëndësishëm për të mundësuar lëvizjen e lirë të specieveve nga njëra anë në tjetrën dhe përbëjnë pjesë të rrjetit ekzistues ekologjik.

Tabela 1-5: Numri i kafshëve i regjistruar në Komunë gjatë studimeve 2011/12

| Lista e referencave   | Gjitarët e mëdhenj | Zogjtë          | Zvarranikët | Amfibët        | Fluturat  | Jokurrizorët ujorë |
|---|--------------------|-----------------|-------------|----------------|-----------|--------------------|
| Lista e kuqe të IUCN (kategoritë afër kërcënimit apo të kërcënuara) | 4                  | 2               | 1           |                | 26        |                    |
| Direktiva e BE për Mjedisin – Florën dhe Faunën – Aneksi II         | 4                  |                 | 2           |                | 4         |                    |
| Direktiva e BE për Mjedisin – Florën dhe Faunën – Aneksi IV         | 1                  |                 | 4           | 5              | 3         |                    |
| Direktiva e BE për (Aneksi I)                                       |                    | 33              |             |                |           |                    |
| Rariteti në Kosovë (Rralla, kërcënuara dhe apo rrezikuara)          | 1                  | 30 <sup>2</sup> |             | 1 <sup>2</sup> | 23        | 3 <sup>3</sup>     |
| Të mbrojtura me Ligjin e Kosovës                                    | 2                  |                 |             |                |           |                    |
| <b>Numri total i specieveve të identifikuar 2011/12</b>             | <b>5</b>           | <b>154</b>      | <b>8</b>    | <b>5</b>       | <b>44</b> | <b>6</b>           |

#### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Mustafa B. dhe H. Ibrahimit 2009, Pierre Galland et al. 2010, FINCHES (NGO) 2011, Ibrahimit H. 2011a, Ibrahimit H. 2011b, EU 2007 dhe 2009, Strauss, A. dhe Pezold, T. (compilers) (2009), Mustafa B. et al. 2009

#### Syngjerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

<sup>1</sup>Të rrezikuara në mënyrë kritike

<sup>2</sup>Rralla

<sup>3</sup>Specie shumë të rralla, 2 nga atome gjasë të reja për Kosovën



### Kufizimet:


Të dhënat për faunën janë të pakompletuara për shkak të mosekzistimit të inventarizimit sistematik. Përderisa të dhëna të pranueshme ekzistojnë për gjitarët e mëdhenj nga anketat e kryera në fshatra dhe informatat nga Drejtoria e Parkut Kombëtar dhe nga OJQ Finches për zogjtë, vështirë që mund të lokalizohen informata (si dhe listë të specieve) ekzituase për zvarranikët, amfibiet, gjitarët e vegjël, peshqit dhe insektet. Është e pritshme, që zona ka potencial të koniderueshëm që të zbulohen më shumë specie të rrezikuara.

Draft final - për miratim





Figura1-2: Fauna (A1.2)





## 1.2. Parku Kombëtar Sharri (A2)

### Përmbajtja e hartës:

- Struktura e pronësisë
- Harta topografike e Komunës së Dragashit me kufinj të Parkut Kombëtar Sharri

### Porositë kryesore:

Parku Kombëtar Sharri në Dragash mbulon 24.206 ha (55,5% e sipërfaqës së teritorit të Komunës). Jashtë parkut do të jenë 19.375 ha (44, 5%). Nuk ka tokë të lërueshme brenda parkut (shih Figura1-4).

- 20.917ha të Parkut Kombëtar janë male dhe zona alpine (më të larta 1.650 m) dhe nga natyra të përshtatshme vetëm për kullosa, pyje dhe mbledhje të produkteve pos drurit dhe turizëm.
- 2.671 ha janë në mes 1.350 dhe 1.650 m lartësi të përshtatshme për menaxhim të kullosave ekstensive dhe
- 563 ha janë 1.350 m afër burimeve të ujit, pyjeve dhe tokës që nuk janë të përshtatshme për bujqësi.
- Për 59 ha nuk ka informata për lartësinë.

Të gjitha përdorimet e mundshme dhe kufizimet brenda parkut si dhe zonat tampon duhet të definohen në një plan të ndarë të menxhimit.

Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri” është shpallur në dhjetor 2012 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.




Figura1-3:Parku Kombëtar Malet e Sharrit, kufiri (Republika e Kosovës dhjetor 2012)

Kufiri është përdorur në të gjitha hartat e vlerësimit për të siguruar informata hapësinore për vlerësimin e ndikimit të Parkut Kombëtar.

Struktura e pronësisë së parkut është 82,8% (= 20.033 ha) në të kaluarën Pronë e Ndërmarrjes Shoqërore (PNSH), 11,5% (=2.794 ha) tokë publike, 3,5% (=841ha) tokë private, dhe për 2,2% (=539ha) të teritorit të parkut nuk ka të dhëna kadastrale në dispozicion.

**Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:**

Kriteret për definimin e Kufinjve të Parkut Kombëtar (Bank et al. 2011):

Zona kryesore është identifikuar sipas vlerave dhe karakteristikave peizazhore dhe natyrore; në shtesë të informatave të pronësisë dhe atyre kadastrale janë marrë edhe fotot e fundit nga ajri. Në mënyrë që të etablohet një determinim i qartë dhe i drejtë harta është bërë në shkallë 1:5.000 duke i përdorur kriteret e më poshtme:

- (1) Zona kryesore në Parkun Kombëtar përbëhet nga toka në pronë të NSH (Sharr Prodhimi) dhe e lidhur me zonat e pyjeve publike / tokë publike. Këto zona gjithashtu kanë biodiversitet të lartë dhe vlerë të lartë të mbrojtjes së natyrës.
- (2) Zonat shtesë janë të përfshira në Parkun Kombëtar kur një apo më shumë parakushte janë prezente:
  - a) Pikat e nxehta të mundshme apo të ditura të biodiversitetit apo vlerave të larta natyrore dhe vlerave të peizazhit jashtë zonave të përmendura nën (1)
  - b) Pronat private të rrethura nga zonat nën (1) janë të përfshira.

**Propozimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:**

Kufizimet:





Figura1-4: Zona brenda dhe jashtë Parkut Kombëtar Malet e Sharrit në Komunën e Dragashit



Figura1-5: Struktura e pronësisë brenda dhe jashtë Parkut Kombëtar Malet e Sharrit në Komunën e Dragashit



Draft final - p...

# Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm për Dragashin – Kosovë



Figura 1-6: Struktura e pronësië brenda Parkut Kombëtar Malet e Sharrit në Komunën e Dragashit (A2.1)









Figura1-7: Harta topografike – Parku Kombëtar Malet e Sharrit në Komunën e Dragashit (A2.2)





## 1.3. Vlerësimi i burimeve të ujit

### 1.3.1. Regjenerimi i ujit, kërcënimi dhe kualiteti (A3.1)

#### Përmbajtja e hartës:

Gjendja e burimeve ujore, kualiteti i tyre dhe kërcënimet

- Kufinj të ujorë dhe nën-ujorë, lumenjtë dhe përrojet, liqenet
- Zonat relevante për mbrojtje dhe ruajtje të burimeve ujore (ligatinoret, pyjet dhe zonat tampon)
- Kualiteti i ujërave sipërfaqësore (kualiteti biologjik, analizat e ujit (KBO) Instituti Kosovar i Shëndetësisë 2012)
- Lumenjtë/ vijat me pak apo pa rrjedhë uji në vitet e thata
- Kërcënimet ndaj kualitetit dhe kuantitetit të burimeve ujore

#### Porositë kryesore:

Kjo hartë përmban ato karakteristikat të burimeve ujore sipërfaqësore të komunës të cilat janë relevante për zhvillim të qëndrueshëm.

“Zonat e rëndësishme ekologjike” lidhur me ligatinoret/ ujë të hapur mbulojnë 1.892 ha (4,3%) të zonës së Dragashit. Sipas nenit 55 të Ligjit për Konservim të Natyrës mbrojtja e ligatinoreve deklarohet si:

1. Ligatinoret përshtirë ujin, në kuptim të këtij Ligji përfaqësojnë vlerat e natyrës dhe për shkak të kësaj duhet të ruhen në gjendjen e tyre natyrore apo afër gjendjes së tyre natyrore.
2. Për rastin e mbrojtjes së ligatinoreve, përfshirë ujin të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Ligj, duhet të aplikohen provizionet e akteve speciale.
3. Cilido liqe apo pellg natyror me, apo aftë argjinaturës më të madhe se 0,01 ha, kënetat natyrore apo artificiale më të mëdha se 0,25 ha, burimet dhe luginat bregore të dy (2) metrave, në kuptim të këtij Ligji përfaqësojnë zona të rëndësishme ekologjike.

Harta përfshin këto zona të cilat gjeologjikisht janë të përshtatshme për rigjenerimin dhe ruajtjen e burimeve ujore, të gjitha pyjet si dhe të gjitha ujërat sipërfaqësore me një tamon prej 20 m (shih Tabela 1-6). Veçanërisht rajoni alpin dhe subalpin i Parkut Kombëtar është i rëndësishëm për furnizim me ujë të pastër.

#### Kualiteti i ujit:

Dy hulumtime në terren, njëra në sezonin e lagësht dhe njëra në sezonin e thatë kanë përdorur një sistem të indikatorit biologjik, dhe këto analiza kanë treguar se 36% e 45 pikave të mostruara kanë pasur kualitetin të ulët apo shumë të ulët dhe 64% kualitet shembullor apo të mirë në sezonin e lagësht. Matjet e KBO nga Instituti Kosovar Hidro-Meteorologjik 2012 konfirmojnë vlerësimin e integruar të kualitetit të ujit (shih Ibrahim 2011b and 2012 dhe UNDP, 2012b) (shih Tabela 2-3).

- **Rajoni i Opojës:** Ndojta nga ujërat e zeza është i dukshëm. Pjesët e lumit poshtë vendbanimeve në përgjithësi janë të ndotura nga ngarkesa organike prej këtyre vendbanimeve. Ndotje më të rënda mund të vërehen në lumin Plava nga drejtimi i fshatit Zaplluxhe deri te pika e fundit poshtë fshatit Rrenc. Fabrika e Trajtimit të Ujërave të Ndotura aktualisht në ndërtim poshtë drejtimit të fshatit Kosovë do të reduktojë vetëm ngarkesën shtesë e cila vie në lumin Plava nga Lumi Kapre. Kjo mund të ndikojë pozitivisht në kualitetin e ujit të lumit Plavë në drejtim të fshatit Zym.
- Brezna nuk ka ndonjë rrjedhë bartëse të ujit. Uji kullohet në liqenin Brezna dhe formon tri kullime përmes karstës në pellgun e lumit të Prizrenit.
- **Rajoni i Gorës:** Lumi Restelica gjithashtu është dukshëm i ndotur mirëpo vetëpastrimi rezulton në kualitet të mirë të ujit nga drejtimi i Krushevës. Lumi Brod ka kualitet shumë të mirë të ujit.
- Gjatë hulumtimeve në ekosistemet e ujërave të rrjedhshme të kryera nga UNDP-ja në pranverë të vitit 2011, janë regjistruar pika të pakontrolluara të shkarkimit të ujërave të ndotura, disa prej tyre pronë e kompanive të cilat lëshojnë ujë të ndotur të patrajtuar në ujërat sipërfaqësore. Këto lokacione janë të shënuara.
- Shumica e rrjedhës së lumenjëve poshtë vendbanimeve janë të ndotura me ndotje të ngurta. Rehabilitimi kërkohet për pjesët e ndotura rëndë. Rehabilitimi do të ishte i qëndrueshëm vetëm në rast të zhvillimit të mekanizmave që do të parandalonin ndotjen e mëtutjeshme.
- Në koridoret me potencial të lartë të erozionit përgjatë lumenjëve ka rrezik nga ndotësit (agrokemikate) dhe plehërat që kullohen në lumenj. Zonat tampon me vegjetacion të pandërprerë dhe kontrolli i erozionit duhet të instalohen.
- Gropat septike, më shumë fabrika të vogla të trajtimit dhe sisteme të menaxhuara të ujërave të zeza janë disa nga kërkesat për zvogëlimin e ndotjes. Kjo ka të bëjë jo vetëm me familjet private por më shumë edhe



me industritë e vogla (REMATEX fabrika e leshit në qytetin e Dragashit, MEKKA fabrika e mishit në Pllavë dhe të gjithë riparuesit e veturave, autolarjet dhe pompat e karburanteve).

## Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

- Lokacionet për vlerësimin e kualitetit të ujit për parametra biologjik dhe kimik: Tabela 2-3, Tabla 2-4 dhe Tabela 2-5, në Aneksin 2.1
- Ibrahim, 2011b dhe 2012
- Sondazhet në teren për burimet dhe rrjedhat e ujit
- UNDP, 2012b
- Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës, 2012

## Sygerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

Pasiqë autoritetet kompetente nuk kanë siguruar të dhëna hapësirore (dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis) të projekteve të vogla të hidrocentraleve, këto të dhëna të planifikuara nuk janë përfshirë. Çdo devijim i mundshëm i ujit mund të rrezikojë kërkesat ligjore minimale të rrjedhës në sezonin e thatë. Këto të dhëna si dhe rrjedha mesatare/mujore duhet të shtohet në bazën e informatave.

Tabela 1-6: Zonat e rëndësishme për regjenerimin e ujit

|  | Zona në ha | Në % të Komunës së Dragashit |
|--|------------|------------------------------|
| <b>Shkëmbinjë me potencial për ujëra nëntokësore</b> | 11.482 ha  | 26,5%                        |
| <b>Ligatinoret</b>                                   | 1.889 ha   | 4,4%                         |
| <b>Pyjet me funksion të rregullimit të ujit</b>      | 2.200 ha   | 5,1%                         |







### 1.3.2. Furnizimi me ujë dhe kërcënimet (A3.2)

#### Përmbajtja e hartës:

Theksimi i kualitetit të furnizimit me ujë dhe kërcënimeve

- Instalimet e tanishme ato të planifikuara të furnizimit me ujë (pikat e ekstraktimit, rezervuarët, burimet)
- Zonat e ndjeshme për furnizimin me ujë (si pikat e absorbimit dhe zonat e tyre tampon)
- Kërcënimet e kualitetit të furnizimit me ujë (pajtimi me standardet)
- Menaxhimi i ujërave të ndotura

#### Porositë kryesore:

##### Furnizimi me ujë të pijes:

- Pikave të shfrytëzuara për ujë të pijes (160 të identifikuar për Planin Master të Ujit) u nevojitet një zonë tampon prej 300 m që parandalon ndotjen direkte dhe shkatërrimin e burimeve.
- 3 pika të nxerjes së ujit të lumit për furnizim me ujë të pijshëm në Rajonin e Opojës kanë nevojë për vëmendje të posaqme në zonat e mbledhjes për mbrojtje nga ndotësit.
- Uji i pijes ruhet në rezervuar. Kualiteti i këtyre rezervuarëve është ekzaminuar nga një sondazh në teren (UNDP, 2012b). 18 nga 66 rezervuarët nuk janë në pajtim me standardet mikrobiologjike dhe/apo kimike sipas standardeve të Kosovës (shih Tabela1-7 dhe Tabla 2-4).

Tabela1-7: Mos pajtueshmëria e kualitetit të ujit në rezervuar

| Fshati               | Mos pajtueshmëria                                   |
|----------------------|---|
| Bellobrad / Belograd | 3 nga 12 nuk janë në pajtim me standardet e Kosovës |
| Dragash              | 1 nga 1   |
| Kosavë / Kosavce     | 3 nga 4   |
| Kuklibeg / Kukljibeg | 1 nga 1   |
| Kukuljane / Kukulane | 1 nga 1   |
| Leštane / Leshtan    | 1 nga 1   |
| Zlipotok / Zlipotok  | 1 nga 3   |

Ka vetëm një objekt për trajtimin e Ujit në Komunë (në qytetin e Dragashit) dhe një e re është planifikuar gjithashtu për qytetin e Dragashit).

##### Instalimete ujërave të zeza:

14 (39%) e fshatrave të komunës së Dragashit kanë sistem të ujërave të zeza/kanalizimit, 14 nuk janë të lidhura në kanalizim dhe 8 janë pjesërisht. 31 nga fshatrat (86%), pavarisht nëse kanë lidhje të plotë, të pjesëshme apo nuk kanë fare lidhje, raportojnë probleme (UNDP 2012: Sondazhi në teren).

Fshatrat që nuk janë të lidhura janë: Bellobrad, Blaç, Bresanë, Brezne, Brod, Buçe, Buzez, Dikance, Dragash, Gllloboçicë, Lubovishtë, Mlikë, Orçushë, dhe Xërxe. Numri i familjeve pa sistem të ujërave të zeza prandaj është 2476, rreth 39% e popullatës së komunës (13,084 persona).

Fshatrat të cilat pjesërisht janë të lidhura janë: Brutit, Kosavë, Krstec/Kërstec, Kuk, Kukulane, Pllajnik, Pllavë dhe Rapçë. Kjo ka ndikim në rreth 20% të popullatës së komunës (6640 banorë; 1251 familje).<sup>4</sup>

Menaxhimi i ujërave të zeza është gati inekzistenet në komunën e Dragashit. Ujërat e zeza shtëpiake lirohen në ujëra sipërfaqësore apo ujëra nëntokësore pa u trajtuar (shih hartën/Figura1-8 për paraqitjen në hartë të pikave të shkarkimit). Ndotësit kryesor për shqetësim përfshijnë ndotësit organik dhe inorganik, nitrogenin dhe komponentet fosforike, metalet e rënda dhe bakteriet patogjene dhe viruset. Ndotësit organik përfshijnë tretësit organik, pastruesit dhe laguesit e yndyrësve dhe materiet tjera toksike organike.

Për momentin një objekt i trajtimit të ujërave të zeza është duke u ndërtuar në lumin Kapre, në drejtim poshtë fshatit Kapre. Fshatrat Kuk, Kosavë, Buzez dhe Kapre do të lidhen në këtë objekt, i cili do të shërbejë për katër nga 27 fshatrat, me një total prej 3335 (2011) banorëve apo përafërsisht 10% të popullatës së komunës.

<sup>4</sup> Të dhënat nga sondazhi i fshatit, bazuar në vlerësimet zyrtare nga 2008.



### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

- Lokacionet për vlerësimin e kualitetit të ujit për parametra biologjik dhe kimik: Tabela 2-3, Tabla 2-4 dhe Tabela 2-5, në Aneksin 2.1
- UNDP 2012: Sondazhet në teren të burimeve dhe rrjedhave
- UNDP, 2012b
- Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës, 2012

### Sygerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

Monitorimi i ujit në tërë Kosovën është i varfër nuk ka të dhëna të mirëfillta hidrologjike. Të dhënat për ndotës specifik dhe informatat për shkarkimet nuk janë në dispozicion.

Draft final - për miratim







## 1.4. Verësimi i rreziqeve natyrore (A4)

### 1.4.1. Rreziku nga erozioni (A4.1)

#### Përmbajtja e hartës:

Harta përshkruan rreziqet e erozionit, bazuar në ndjeshmërinë e tokës. Të përfshira janë edhe tokat potenciale jostabile rreth rrugëve (duke përdorur gjerësinë e rrugës). Zonat e rrezikuara nga erozioni i tokës janë funksion i:

- llojit dhe cilësive të tokës,
- precipitimit,
- pjerrtësisë,
- menaxhimit të përdorimit të tokës,
- mbulimit me vegjetacion.

#### Porositë kryesore:

Harta lejon identifikimin e zonave me nevojë për masat e stabilizimit të tokës dhe menaxhimit në mënyrë të duhur të tokës/formave të përdorimit të tokës. Marrja në konsideratë e rrezikut nga erozioni është veçanërisht e rëndësishme për bujqësi dhe menaxhim të kullotave për çfarëdo aktiviteti të ndërtimit. Vlerësimi duhet të ketë pasojë për parandalimin e masave për përmirësimin e rrugëve dhe ndërtimeve si dhe për planifikimin e aktiviteteve të ri-pyllëzimit.

Zonat kryesore bujqësore të Opojës kanë vetëm risk të vogël apo mesatar nga erozioni. Mirëpo, një menaxhin i kujdeshëm i kullotave intensive dhe i fushave të punueshme është i nevojshëm. Kjo përfshin mirëmbajtjen / mos shkatërrimin e tarracave dhe gardheve në tokat bujqësore. Rreziku i erozionit të tokës është poshtu i ulët në tokat barishtore në lartësi të Maleve të Sharrit të cilat karakterizohen me pjerrtësi të ulët. Zonat kryesore me rrezik të lartë të erozionit të tokës janë të lokalizuara në shpatiet e pjerrëta të luginave të malit të Sharrit dhe në Malin Koritnik.

Error! Not a valid result for table. Tabela tregon se rreziku nga erozioni nuk varet aq shumë nga lartësia e terrenit. Mirëpo, në fushat e punuara nën 1.300 m mbi nivelin e detit rreziku nga erozioni është pak më i ulët se në zonat me lartësi më të madhe mbidetare.

Figura 1-11 tregon se brenda zonave kadastrale të Baçkës, Brodit, Kërstecit, Orçushës, Radeshës dhe Rapçës rreziku nga erozioni i tokës është më i larti me pjesëmarrje totale të zonave me rrezik shumë të lartë apo të lartë, më shumë se 60% të zonës kadastrale; mesatarja për komunë është 53,4% që janë zona me rrezik shumë të lartë dhe të lartë. Në anën tjetër zonat kadastrale Bellobrad, Buzez, Dragash, Kapre, Pllavë dhe Zym përbëhen nga më shumë se 70% të tokave të tyre me rrezik të moderuar apo të ulët të erozionit të tokës.

Fshatrat Restelicë, Pllavë, Blaç, Brrut, Gilloboçicë, dhe Radeshë janë të prirura për erozion të tokës në afërsi të tyre. Ky fakt duhet të merret parasysh në zhvillimin e mëtutjeshëm hapësinor të këtyre vendbanimeve.

#### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Modeli është i skicuar në "Modeli i rrezikut" (Aneksi 2.2) (EULUP 2011)

#### Sygerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

Kualiteti i analizave të rrezikut varet shumë nga siguria e të dhënave të futura. Sidomos harta e tokës në dispozicion është e një besueshmërie të kufizuar për shkak të madhësisë së vogël së saj.

Analizat mund të përmirësohen dukshëm me përdorimin e të dhënave më të detajuara të tokës.



Figura1-10: Rreziku i erozionit të tokës në klasat e ndryshme të lartësisë





Figura1-11: Rreziku nga erozioni i tokës në zonat kadastrale të komunës së Dragashit











## 1.4.1. Rreziku nga orteqet (A4.2)

### Përmbajtja e hartës:

Harta përshkruan rrezikun nga orteqet bazuar në modelin që përdor:

- Pjerrtësinë
- Drejtimin e erës në kombinim me kreshtat dhe depresionet
- Ekspozimin
- Gjatësinë e shpatieve dhe diversitetin e formave të tokës
- Vegjetacioni, veçanërisht pyjor/ jo-pyjor

### Porositë kryesore:

Rreziku nga orteqet është më i lartë në zonat malore dhe duhet të konsiderohet në rast të planifikimit të instalimeve të sporteve dimërore. Sidoqoftë më poshtë janë pikat e rëndësishme për zonat e banuara dhe rrugët që duhet të mirren parasysh serizosht:

- Restelica është vendbanimi me rrezikun më të lartë dhe të vazhdueshëm nga orteqet në Dragash
- Shumica e fshatrave tjera janë nën rrezikun mesatar për orteqe nga bora e lagësht. Vetëm në Blaç ka zona të vogla me rrezik më të lartë. Fshatrat tjera me zona të rrezikut të lartë janë së paku të mbrojtura nga pyjet
- Rrugët Glloboçicë – Restelicë dhe Dikance – Baçkë – Brod dhe rrugët lidhëse në mes të fshatrave Kosovë, Xërxe dhe Pllajnik janë në rrezik. Pyjet përgjatë këtyre rrugëve kanë nevojë për mbrojtje të kujdeshme (shih gjithashtu vlerësimin e funksionimit të pyllit Figura1-22: Vlerësimi i funksioneve të pyllit (A5.2)) dhe apo rryllëzimin.
- Mbrojtja ekzistuese pyjore nga orteqet duhet të mbrohet, të mirë menaxhohet dhe të zgjerohet.
- PZHK duhet të parapsheh pyllëzimin në zonat me rrezik mesatar dhe të lartë rreth fshatrave ku kushtet e tokës e lejojnë një gjë të tillë
- Për mbrojtje afatshkurtër apo në hapësirat ku pyllëzimi nuk është i mundur, mbrojtja teknike është e këshilueshme
- Kontrolli i djegies së qëllimshme/paqëllimshme të zonave shkurre, shkorriëve dhe komuniteteve të drunjëve Juniperus (iniciativat e komunitetit dhe kontrollit)
- PZHK duhet gjithashtu të përcaktojë zgjerimin e fshatit vetëm në zonat që nuk janë të rrezikuara nga ortequ.

Figura1-13 tregon shumën e orteqeve brenda teritorit të komunës:

- Një total prej 1.185 ha tregon rrezik të shtuar nga orteqet për shkak të ekspozimit ndaj VP në VL dhe shpatieve më pjerrtësi më të madhe se 30 shkallë, nga këto 801 ha nuk janë të mbrojtura nga pyjet.
- 1.774 ha shtesë tregojnë rrezik të lartë nga orteqet, nga të cilat 1.344 ha nuk janë të mbrojtura nga pyjet.
- 4.223 ha tregojnë rrezik të shtuar potencial për shkak të ekspozimit ndaj VP në VL dhe shpatie në mes 20 dhe 30 shkallë, nga të cilat 3.004 ha nuk janë të mbrojtura nga pyjet.
- 6.867 ha tregojnë rrezik potencial, nga të cilat 5.333 ha nuk janë të mbrojtura nga pyjet.

Figura1-14 japin një pamje në afërsi direkte (300m radius) të këtyre vendbanimeve:

- Një total prej 185 ha tregon rrezik të lartë apo rrezik të lartë të ngritur, nga të cilat 141 ha nuk janë të mbrojtura nga pyjet.
- Një total prej 855 ha tregon rrezik potencial, 647 ha nuk janë të mbrojtura nga pyjet.

### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Modeli është i skicuar në "M" (Aneksi 2.3), <http://www.powderguide.com/de/mountain-knowledge/basics/article/mountain-knowledge/>

Modeli i aplikuar identifikon vetëm rajonet ku orteqet mund të shfaqen, **zonat ku orteqet mund të kalojnë apo godasin nuk janë identifikuar** nga ky model.

### Sygerimet e mëtejshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

Në rastin e Restelicës një analizë e detajuar është ekzekutuar nga një ekip Austriak në ndërkohë. Analiza të ngjajshme duhet të kryhen për zonat e tjera të rrezikut të lartë (fshatrat dhe rrugët e rëndësishme).



Figura1-13: Zonat e rrezikuara nga orteqet brenda Komunës




Figura1-14: Zonat me rrezik nga orteqet brenda distancës 300m nga vendbanimet







Figura1-15: Vlerësimi i rrezikut nga orteqet (A4.2)





### 1.4.2. Zonat e rrezikuara nga rrëshqitja e dheut, gurëve dhe zonat e prira për përmbytje

#### Përmbajtja e hartës:

Harta përshkruan zonat e rrezikuara nga rrëshqitja e dheut, gurëve dhe ato të prira për përmbytje bazuar në modelin që përdor :

- Pjerrtësitë
- Sedimentet kuaternare
- Zonat me vegjetacion të pakët / shkëmbinjtë
- Llojet e shkëmbinjëve
- Zonat me vegjetacion të pakët

- Zonat e prira për përmbytje – sipas komunikimit me fshatrat
- Zonat e prira për zjarre – sipas komunikimit me fshatrat

#### Porositë kresore:

Rreziqet nga rrëshqitja e tokës dhe shkëmbinjëve janë më shumë në malet e larta në zonat subalpine dhe alpine të pabanuara dhe mund të jenë të rëndësishme për ekskursionet në këmbë dhe barinjët. Megjithatë ka rreziqe të mëdha afër rrugëve dhe banimeve në Blaç, rreth Restelicës dhe në zonën në më të Dikances dhe Brodit.

Tabela 1-8 tregon gjatësinë e rrugëve lokale dhe rajonale të prira për rrëshqitje të tokës apo shkëmbinjëve.

Tabela 1-8: Rrugët e ekspozuara ndaj rreziqeve të rrëshqitjes së tokës dhe shkëmbinjëve

|                        | Gjatësia e ekspozuar ndaj rrezikut të rrëshqitjes së tokës apo shkëmbinjëve në m |  |   |
|------------------------|--|--|---|
|                        | Kalimi nëpër zona të shkëmbore të zhveshura                                      | Kalimi nëpër zona me vegjetacion të rrallë | Kalimi nëpër shtretër torrent të prirur për rrëshqitje të tokës |
| <b>Rrugët lokale</b>   | 235m   | 7.595m                                     | 96m   |
| <b>Rrugët rajonale</b> | 47m  | 2.480m                                     | 51m   |

Zonat e prira për përmbytje nuk janë shumë të përmendura në komunë dhe përmbytjet janë të rralla. Zonat e prira për zjarre nuk bazohen në inventarizim sistematik dhe nuk janë të plota. Kryesisht zonat shkurre dhe pyjet e keq menaxhura si dhe plantacionet e pishave, veçanërisht gjatë motit të nxehtë dhe situatave klimatike të thata në sezonin e verës janë të prira për zjarre. Rreziku i vetëdëzjes është i ulët por, zakonet për të ndezur fushat e korrura dhe shkurret në malet e larta janë një problem serioz.

#### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Modeli është i skicur në “Modeli për rrezikun e rrëshqitjeve të tokës” (Aneski 2.3)

Modeli i aplikuar identifikon vetëm rajonet ku rrëshqitjet e tokës dhe shkëmbinjëve numd të paraqiten, **zonat ku rrëshqitjet e tokës dhe të shkëmbinjëve mund të kalojnë apo godasin nuk janë të identifikuar** nga ky model.

#### Sygerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:


Investarizim sistematik i zjarreve, për shkak se të dhënat në dispozicion janë jo të plota, të bazuara në informatat e fshatarëve.

Inventarizimi sistematik i segmenteve të rrugëve të ekspozuara nga rrëshqitjet e shkëmbinjëve është i nevojshëm, pasi që analizat e bazuara në GIS nuk e reflektojnë mjaftueshëm rrezikun.





Figura1-16: Vlerësimi i rrezikut të rrëshqitjes së tokës dhe zonave të prira për përmbytje (A4.3)





## 1.5. Vlerësimi i pyllit dhe bujqësisë (A5)

### 1.5.1. Gjendja e pyjeve (A5.1)

#### Përmbajtja e hartës:

Harta tregon strukturën e vjetërsisë së pyjeve publike dhe private si dhe sjell informata bazike për klasën e menaxhimit, përfshirë zonat me dendësi të lartë të pyjeve të degraduara.

#### Porositë kryesore:

Qindra vjet të kullotjes kanë lënë rreth 17,1 % të një zonë të pyllëzuar të Komunës së Dragashit me 8.124 ha me pyje të lokalizuara në pjesën veri-perendimore të zonës. 5.199 ha të të gjitha pyjeve janë publike (64 %) përfshirë edhe pyllin e vjetër të Pinus heldreichii me një vjetërsi prej 70 vjetëve. Nga ky pyll në malin e Koritnikut, 1.160 ha janë pjesë e Parkut Kombëtar të planifikuar dhe një prej pikave të rëndësishme të biodiversitetit në Komunë.

Pyjet private (2.925 ha) janë kryesisht pyje cungishte (2.814 ha) dhe një burim i rëndësishëm i drurit për zjarr për komunitetin. Totali i pyllit cungishte është 4.048 ha.

Plantacionet mbulojnë 211 ha (përafërsisht 3 % të pyllit në total) vetëm një pjesë e vogël në veri të Dragashit.

2.462 ha e pyjeve në tokë të hollë ka nevojë për kujdesje speciale në menaxhim të pyjeve në mënyrë që të parandalohet erozioni dhe të ruhen kapacitetet e mbajtjes së ujit.

18 ha të pyllit janë të degraduara për shkak të prerjes ilegale, zjarreve të pyllit apo për shkak arsyeve tjera që nuk janë të specifikuar.

Pyjet e përziera, pyjet më të vjetra së 70 vjet dhe tranzicionet alpine nga pyjet në toka me barë në linjën e drurëve janë vendbanime të ariut dhe rrëqebullit dhe janë pjesë e korridoreve ekologjike rajonale.

#### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Arneni, N.SH.T (2011), MAFRD-KFA (2009, 2010a dhe b)

#### Sygerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

Toka – lidhja e pyjeve, veçanërisht toka e hollë duhet të verifikohet me hetime në teren. Vendet potenciale për ripyllëzim prioritar duhet të derivojnë nga harta e vlerësimit të rrezikut (Figura1-12, Figura1-15 and Figura1-16)

Tabela1-9: Të hyrat nga prerja e pyjeve në sektorin publik/privat

| Njësia menaxhuese | Të hyra nga vjelja n Euro | Shpenzimet e vjeljes dhe ekstraktimit | Të hyrat neto vjetore në Euros | Volumi potencial vjetor i vjelur / m 3 |
|-------------------|---------------------------|---------------------------------------|--------------------------------|--|
| Koritniku II      | 229 858                   | 83 067                                | 146 791                        | 5 358                                  |
| Opoja             | 184 685                   | 55 085                                | 129 600                        | 4 879                                  |
| Bredhiku          | 260 717                   | 80 553                                | 126 164                        | 7 104                                  |
| <b>Shuma</b>      | <b>675 260</b>            | <b>218 705</b>                        | <b>402 555</b>                 | <b>17 341</b>                          |
| Pyje private      | 92 925                    | 35 407.74                             | 57 517.3                       | 4425.97                                |
| <b>Totali</b>     | <b>768 185</b>            | <b>254 112.74</b>                     | <b>514 072.3</b>               | <b>21 766.97</b>                       |

(Të dhëna zyrtare dhe të UNDP për pyjet private)

Tabela1-10: Mundësitë e punës në hollësim dhe pastrim

| Komunat | Zona për hollësim | Norma (ditë pune)             |     |     | Numri total i ditëve të punës |
|---------|-------------------|-------------------------------|-----|-----|-------------------------------|
|         |                   | Vjelja/Ekstraktimi/Transporti |     |     |                               |
| Dragash | 2 000 ha          | 606                           | 400 | 200 | 1 206                         |




Figura1-17: Situtata e pronësisë në pyjet e Dragashit (në ha)




Figura1-18: Klasat e vjetërsisë në pyjet e Dragashit (në ha)




Figure 1-19: Kërkesat specifike të menaxhimit në pyjet e Dragashit (në ha)







## 1.5.2. Funkcionet e pyllit (A5.2)

### Përmbajtja e hartës:

Funkcionet e pyllit që përfshijnë:

- Prodhimin e drurit (drurit për zjarr, lëndë druri të vlefshëm, mbledhja e produkteve tjera pos drurit)
- Funkcionet e mbrojtjes (erozioni i tokës, orteqet, rreshqitjes së tokës dhe shkëmbinjëve)
- Biodiversiteti
- Rregullimi i ujit dhe furnizimit me ujë

### Porositë kryesore:

Funkcionet e pyllit janë mjete për identifikuar dhe adresuar më mirë rolet dhe vlerat specifike të pyjeve në mënyre që të rritet efektiviteti dhe kapaciteti i tyre. Funkcionet e pyllit janë të krahasueshme me parimin e Pyjeve me Vlerë të Lartë të Konzervimit (HCV) nën FSC.

Nga 8.124 ha të pyjeve, vetëm 230 ha nuk kanë ndonjë funksion të dedikuar (3%) (referojuni **Figura1-21**)

Praktikat e menaxhimit të pyllit duhet të marrin parasysh jo vetëm funksionet prodhuese, por gjithashtu biodiversitetin, dhe funksionin e rregullimit të ujit të pyjeve.

Informata është e përdorur si udhëzues për zbatimin e pyllit, rezistenca hapësinore, përfshirë mbrojtjen nga rreziqet natyrore, relevante për planifikimin e trafikut dhe vendbanimeve dhe planin e menaxhimit të Parkut Kombëtar.

### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Kriteret e vlerësimit janë të listuara në Aneksin 2.3; Funkcionet e pyllit janë të vendosura në relacion me llojet HCV në Tabela1-11.

Arneni, N.SH.T (2011), MBPZHL-APK (2009, 2010a dhe b)

### Sygerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

Të dhënat për pyjet publike janë kualitative (shih Arneni, N.SH.T, 2011, MBPZHL-APK, 2009, 2010a dhe b) dhe lejojnë vlerësim të besueshëm të funksioneve. Zonat me një funksion të biodiversitetit mund të rriten nëse bëhen hulumtime më intensive nëse gjenden më shumë veçanti të florës dhe faunës.


Tabela1-11: Klasifimi i funksioneve të pyllit

| Funkcioni                                      | Shërbimi për ekosistemin / Specifikimi   | Shembulli  | Lidhur me llojin e HCV |
|--|--|--|------------------------|
| Prodhimi i drurit                              | Ky porcion i bruto i prodhimit është i ekstraktueshëm si lëndë e parë  | Prodhimi i lëndës drurore, apo karburantit / drurit për djegie   | HCV 5 (dru për zjarr)  |
| Prodhimi i produkteve jo drursore              | Ky porcion i bruto prodhimit primar është i ekstraktueshëm si lëndë e parë apo produkte primare.   | Prodhimi i peshqve, lojrat, të lashtat, arrat, frutet nga gjuetia, mbledhja, peshkimi apo ferma për nevoja të familjes     | HCV 5                  |
| Kontrolli i erozionit dhe ruajtja e sedimentit | Ruajtja e tokës brenda ekosistemit   | Parandalimi i humbjes së tokës nga era, lëvizjet apo proces tjetër të lëvizjes, ruajtjen e gurëzave në liqe dhe nëligatore | HCV4                   |
| Mbrojtja nga rreziku                           | Mbrojtja nga orteqet, rrëshqitjet e tokës dhe të shkëmbinjëve  | Pyjet në shpatijet prej 20 shkallëve dhe më shumë sjellin mbrojtje të mirë nga orteqet                                     | HCV4, HCV5             |
| Biodiversiteti                                 | Mjedise globale, rajonale dhe lokale të rëndësishme për llojet e bimëve dhe kafshëve, speciet në mjedise të pasura (apo mjedise komplekse) | Vendet, mjediset për specie që migrojnë, mjediset rajonale për specie lokale të vjelura, apo në vendet ku dimërohet        | HCV1, HCV2, HCV3       |



| Funksioni                              | Shërbimi për ekosistemin / Specifikimi                          | Shembulli   | Lidhur me Ilojin e HCV |
|--|---|---|------------------------|
| Regullimi i ujit dhe furnizimit me ujë | Rregulimi i rrjedhave hidrologjike, Deponimi dhe mbajtja e ujit | Provizionimi i ujit për konsumin nga njerëzit në kualitet dhe kuantitet të mire | HCV4                   |
| Kulturor (nuk është vlerësuar në AZHQ) | Sjellja e mundësive për përdorime jo-komerciale.                | Estetike, artistike, edukative, spirituale dhe aktivitete shkencore.            | HCV6                   |

Figura1-21: Zona e pyllit e dedikuar për funksione të ndryshme (në ha)







### 1.5.3. Kapaciteti prodhues i tokës (A5.3)

#### Përmbajtja:

Qëndrueshmëria e tokës sipas:

- Pjelloria II2 – III1 (më e mirë) nga VII1 - VIII2 (kufizime madhore)
- Kullota intensive
- Kullota ekstenzive

#### Porositë kryesore:

Nga klasa 8 e pjellorisë nuk ka klasë I, por klasë II, klasë III, klasë V, klasë VI, klasë VII, dhe klasë VIII (Elezi 2011 dhe "Error! Reference source not found." Aneksi Error! Reference source not found.).

- Përshtatshmëri me kufizime të vogla: Klasat II dhe III të pjellorisë. Të gjitha kulturat bujqësore mund të kultivohen në këto toka, me pak apo potencial të lartë të mekanizimit.
- Përshtatshmëri me kufizime më të shprehura: Klasa e pjellorisë V (klasa IV mungon). Të gjitha kulturat bujqësore mund të kultivohen në këto toka, por me mundësi të vogël të mekanizimit.
- Përshtatshmëri me shumë kufizime: Klasa e pjellorisë VI. Edhpse këto toka kanë kufizime të gjëra, këto tradicionalisht janë të përdorura për prodhimin e ushqimit për kafshët (sanës) dhe / apo kullotave të gjëra.
- Përshtatshmëri me kufizime të gjëra: Klasa e pjellorisë VII dhe VIII. Nuk është e mundur të kultivohet në këto toka dhe zakonisht përdoren si kullota të gjelbra.

Përgjithësisht, prodhimi i të lashtave në teritorin e komunës është shumë i gjerë, në shumicës e tipeve/klasave të tokës, për shkak të fertilitetit të limituar (kapacitetit prodhues) dhe të topografisë që sjell kufizime të konsiderueshme për produktivitetin bujqësor/mekanizimin. Përveç kësaj ka nivel të vogël të investimeve, nivel të vogël të mekanizimit dhe nuk ka orientim drejt tregut (prodhimi kryesisht për nevoja lokale).





Figura1-23: Përshtatshmëria e tokave (në ha)



Sipas Komunës së Dragashit-Departamenti i Bujqësisë (2011) është dokumentuar si më poshtë:

| Tokat e punueshme | Livadhet | Kullotat  | Kullotat Malore | Totali    |
|-------------------|----------|-----------|-----------------|-----------|
| 3.596,79          | 5.196,20 | 26.042,00 | 6.424,76        | 41.259,75 |
| 9%                | 13%      | 62%       | 16%             | 100%      |

#### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Komuna e Dragashit – Departamenti i Bujqësisë, 2011, Elezi 2011,


#### Sygerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

Zonat me aplikim të pesticideve dhe plehrave janë të pakta (të dhëna të pakompletuara nga komuniteti).





Figura1-24: Vlerësimi i kapacitetit prodhues të tokës (A5.3)







## 1.5.4. Bagëtia dhe përshtatshmëria për të lashta (A5.4)

### Përmbajtja:

Harta thekson zonat e:

- përshtatshme për të lashta (nën 1300 m dhe me pjerrtësi nën 30° në 4kategorori)
- përshtatshme për kullota (nën 1600 m - 3 kategorori)
- përshtatshme për kullota ekstensive mbi 1600 m
- për çdo fshat ha të tokave të punës, ha të tokave të punës heterogjene, ha të kullotave dhe ha të tokave me barë (mbi lartësinë 2.000 m)
- për çdo fshat numri i lopëve/njësive të bagëtise, deleve/njësive të bagëtisë

### Porositë kryesore:

Zonat e përshtatshme për bujqësi nën 1300 m me periudhë të vegjetacionit më të gjatë se 5 muaj. Të lashtat kryesore të mundshme janë misri, patatet/patatet për mbjellje, drithërat e verës dhe dimrit dhe frytat / drunjtë frytorë. Në aneksin Error! Reference source not found., "Tabela 2-7: klasat e përshtatshmërisë dhe niveli i shfrytëzimit për kulturat e caktuara, bazuar në mënyrën e kultivimit dhe nivelin e makinerisë", më shumë detaje për të lashtat e rekomanduara janë të listuara. Në mes të lartësisë 1300 m dhe 1600 m periudha e vegjetacionit prej 5 muajsh lejon vetëm kullota intensive dhe ekstensive.

Livadhet në lartësi më të madhe se 1600 m përgjithësi janë të përshtatshme vetëm për kullotë ekstensive në pranverë e vonë dhe gjatë muajve të verës. Mbi 2.000 m livadhet janë natyrore.

Struktura e bujqësisë/bagëtisë për çdo fshat është e treguar në një listë të 2001 ku tregohet zona e mundshme bujqësore, numri i bagëtisë (gjithashtu në njësi të bagëtisë ku 1 dele është e kalkuluar me 0,15 njësi të bagëtisë) (Departamenti i Bujqësisë - Dragash-2011). Në përgjithësi ka 74 ferma me dele dhe 74 bari aktiv. 10 ferma me më shumë se 5 lopë të cilat prodhojnë qumësht për tregun. Numrat e bagëtive si më poshtë janë dokumentuar:

| Gjedhe        | Dele           | Dhi        | Kuaj        | Totali    |
|---------------|----------------|------------|-------------|-----------|
| 6.450 (39,3%) | 9.506 (57,92%) | 34 (0,21%) | 423 (2,58%) | 16.413,00 |


Për kullota të zonave subalpine dhe alpine (livadhet me Nardion dhe ato gëlqerore) BE rekomandon një kapacitet bartës prej 1.3 - 4.0 delesh (1.2 derj 0,6 njësi bagëtish) për një periudhë prej 100-ditëve të kullotjes (Komisioni Evropian 2008a dhe b). Numri aktual i gjedheve dhe deleve (në përgjithësi) nuk e tejkalon kapacitetin e tokave më barë. Mirëpo, nuk ka të dhëna të sakta për tokat me kulloso në dispozicion për AZHQ për shkak se kopetë nuk përdorin kullosat vetëm në fshatrat e tyre dhe delet nga fshatrat jashtë Dragashit kulloten gjithashtu.

### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Komuna e Dragashit – Departamenti i Bujqësisë, 2011, Elezi 2011, Komisioni Evropian 2008a dhe b



Figura1-25: Vlerësimi i bagëtisë dhe përshtatshmëria për të lashta (A5.4)





## 1.6. Vlerësimi i mbeturinave të ngurta (A6)

### Përmbajtja e hartës:

Vlerësimi i mbeturinave të ngurta për çdo fshat:

- Mbledhja e mbeturinave: Numri i banorëve, meturinat vjetore të mbledhura, përfshirja në sistemin e mbështetur nga UNDP-ja dhe qasja gjatë kohës së dimrit
- Hedhja e egër e pakontrolluar e mbeturinave: Numri i pikave ilegale të hedhjes dhe një përlogaritje në ton, numri i pikave të hedhjes të larguara në 2012
- Biznesi aktiv i reciklimit

### Porositë kryesore:

Mbeturinat e ngurta janë një prej brengave kryesore të komunës. Deponimi joprofesional i mbeturinave krijon një seri të problemeve: kërcenime për higjienën, lirim të toksineve përmes djegjes së mbeturinave ku ndotet ajri dhe uji, shpesh kafshët ushqehen me substanca të mbetura plastike/ substanca helmuese, xhamat e thyer rrisin rrezikun e nxitjes së zjarreve, peizashi bëhet shumë jo atraktiv.

Vlerësimi reflekton mungesat si dhe tentimet dhe sfidat në sektorin e mbeturinave.

Rreth 97 pika ilegale (me rreth 1.065 t mbeturina), zakonisht afër rrugëve dhe në brigjet e lumenjëve janë identifikuar. Identifikimi i deponive të materialit ndërtimor nuk është bërë në mënyrë sistematike, por shton problem për ndotjen e tokës.

Sistemi i mbledhjes së mbeturina ka filluar të punojë në 2012.22 fshatra janë përfshirë në sistemin e mbledhjes së mbeturinave dhe të tjerat do të përfshihen në vitin 2013. Mirëpo, qasja nuk është e sigurt për 10 nga fshatrat.

Një pikë e hedhjes në veri perëndim të Bellobradit është duke funksionuar. Ka filluar reciklimi në Gllaboçice dhe Kosave për plastikë, letër dhe hekur. 12 nga pikat e hedhjes janë pastruar gjatë aktivitetëve të 2012.

### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Studim vetanak, informata nga kompania e mbledhjes të mbeturinave ("Ekregjioni"), intervistat dhe punëtoritë me përfaqësuesit e Komunës dhe fshatrave. Numrat dhe kuantiteti i mbeturinave dhe pikat ilegale të hedhjes së mbeturinave nuk janë shterruar.

### Sygerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

Kompletimi i mëtutjeshëm i lokacioneve dhe kuantiteteve të mbeturinave të ngurta të mbeturinave të ndërtimit për të mbështetur qëllimin e "Plani lokal i veprimit të biodiversitetit nëkomunën e Dragashit 2011-2015" (Komuna e Dragashit 2010 – Qëllimi 6 Preventiva e ndotjes së tokës)







Mbledhja e mbeturinave bëhet nga dera në derë dhe nga kontenjerët, të cilët janë të vendosur në pika të caktuara në fshatra. Transportimi i mbeturinës nuk kalon ndonjë trajtim preliminar kështu që tërësia e mbledhur shkon drejtë në epikat e hedhjes.

Tabela1-12: Total i mbledhur i mbeturinave në 2008 (ton)

| Fshtrat           | Ton/viti |
|-------------------|----------|
| 1. Dragash qyteti | 341      |
| 2. Blaç           | 44       |
| 3. Bellobrad      | 266      |
| 4. Kapre          | 91       |
| 5. Zym            | 138      |
| 6. Zapluxhe       | 301      |
| 7. Buzez          | 73       |
| 8. Bresanë        | 672      |
| 9. Kuk            | 293      |
| 10. Kuklibeg      | 168      |

|                |             |
|----------------|-------------|
| 11. Kosovë     | 182         |
| 12. Brrut      | 184         |
| 13. Pllavë     | 236         |
| 14. Shajne     | 233         |
| 15. Rrenc      | 172         |
| 16. Zgatar     | 163         |
| 17. Brezne     | 400         |
| 19. Buçe       | 172         |
| 20. Rapça      | 263         |
| 21. Lubovishtë | 194         |
| 22. Restelicë  | 820         |
| <b>TOTAL</b>   | <b>5406</b> |





## 1.7. Vlerësimi i potencialit për trashëgimi kulturore dhe turizëm (A7)

### Përmbajtja e hartës:

Atraksionet ekzistuese dhe potencialet turistike

- Trashëgimia kulturore (pikat arkeologjike dhe arkitekturore, dhe peizazhi kulturor)
- Pikat natyrore (si shpellat, burimet, ujëvarat etj.)
- Infrastruktura turistike (si hotelet, restaurantet, pikat e ndaljes për autobusë dhe postat)
- Shtigjet për ecje në natyrë dhe për ciklizëm malor si dhe vendet për kampim

### Porositë kryesore:

Harta tregon informata relevante për turizëm të cilat janë të nevojshme për zhvillim të integruar për një koncept të qëndrueshëm të turizmit. Me konceptin e shtigjeve të ecjes (Wassel 2011) është barë hapi i parë për mbështetjen e zhvillimit të turizmit (ciklizëm malor, shtigje të ecjes dhe kampim).

Përveç shtigjeve të ecjes, edhe tri zona potenciale për zhvillimin potencial të turizmit, bazuar në infrastrukturën ekzistuese janë identifikuar: njëra si koridor nga Brodi në Restelicë, një në malet sipër Zaplluxhes (zonë e planifikuar e skijimit) dhe zona e lumit Blaç/Belobrad nga Zaplluxha në Brezne.

Një inventarizim i fundit i trashëgimisë kulturore të Kosovës (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, shih UNDP (2012c)) përfshinë një listë prej 12 pikave, monumenteve dhe artefakteve të cilat janë në mbrojtje të përkohshme kombëtare, përfshirë tre monumente që kanë qenë më parë të mbrojtura nga Ligji Jugosllav (Tabela1-14). Sipas skemës së vlerësimit (shihTabela1-13) katër nga fshatrat janë klasifikuar me vlerë të shumë të lartë të trashëgimisë kulturore, shtatë me vlerë të lartë dhe 19 me vlerë të mesme.

Dragashi tani për tani ka objekte të limituara për të mbështetur vizitorët, edhe përkundër potencialit të zonës për skijim dhe aktivitete të jashtme. Me 3 hotele (njëri nga ta në Zaplluxhe nuk është funksional për momentin) dhe pa mundësi të formalizuara të shtretërve/mëngjesit ka një deficit të madh për zhvillimin e turizmit. Objektet e sporteve dimërore janë në mënyrë marginale të mundshme vetëm nëBrod (Hoteli Arxhena dhe Ski lifti).

Shërbimet e transportit të rregullt publik janë të limituara vetëm në lidhjen nga Prizren në Dragash dhe Zaplluxhe dhe nuk përfshijnë qendrat kryesore dhe pikat e hyrjes në pikat e Parkut Kombëtar Malet e Sharrit në Dragash.

### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Wassel (2011): Guida e Ecjes dhe Turizimit në Natyrë

UNDP (2012c): Asetet Kulturore dhe të Trashëgimisë në Komunën e Dragashit.

UNDP (2011): Projekti i Dragashit: Pyetësor për fshatin dhe Punëtorja për Vizionim e Planit të Zhvillimit të Komunës Shtator 2011

### Syqjerimet e mëtutjeshme për monitorim dhe/apo përmirësim të të dhënave:

Restaurantet në dispozicion dhe të tjerat, lokacione më të vogla me ushqim të ofruar si dhe hotelet/ mundësitë me shtretër/mëngjes janë shumë dinamike dhe ka shumë të ngjarë që nuk janë të kompletuara.

Rrugë skenike interesante dhe pika të vrojtimit të jashtëzakonshme janë vënë në hartë gjatë elaborimit të strategjisë së turizmit dhe ofertës së përmirësuar të Komunës dhe përmirësimit të objekteve të Parkut Kombëtar "Sharri".





Tabela1-13: Matriksi i vlerësimit të trashëgimisë kulturore


|                                |   | Numri i objekteve të trashëgimisë |                |                |                |
|--------------------------------|---|-----------------------------------|----------------|----------------|----------------|
|                                |   | 1                                 | 2              | 3              | 4              |
| Numri i objekteve të mbrojtura | 0 | mesatare                          | mesatare       | lartë          | shumë i lartë  |
|                                | 1 | lartë                             | lartë          | shumë të lartë | shumë të lartë |
|                                | 2 | X                                 | shumë të lartë | shumë të lartë | shumë të lartë |

Tabela1-14: Zonat kryesore të trashëgimisë kulturore në komunën e Dragashit

| Fshati                           | Lloji i trashëgimisë | Emri                        |
|----------------------------------|----------------------|-----------------------------|
| <b>Të mbajtura plotësisht</b>    |                      |                             |
| Brrut                            | Arkeologjike         | Brrut-hisar                 |
| Zlipotok                         | Arkeologjike         | Hisarisht                   |
| Bresanë                          | Arkitekturore        | Xhamia e Kuklibeut          |
| <b>Të mbrojtura përkohësisht</b> |                      |                             |
| Shajne                           | Arkitekturore        | Mulli                       |
| Kapre                            | Arkitekturore        | Xhamia e Kapres             |
| Zlipotok                         | Arkitekturore        | Vendi i Xhamisë më parë     |
| Kapre                            | Arkitekturore        | Sallatash                   |
| Bellobrad                        | Arkitekturore        | Mulli me ujë                |
| Buzez                            | Arkitekturore        | Namazxhah                   |
| Dragash                          | Arkitekturore        | Tyrbe                       |
| Mlike                            | Arkitekturore        | Xhami                       |
| Restelicë                        | Arkitekturore        | Varri i Selim Dedes (tyrbe) |



Figura1-27: Vlerësimi i trashëgimisë kulturore dhe i potencialit të turizmit (A7)





## 1.8. Vlerësimi i shëndetit, shërbimeve mjekësore dhe mbrojtjes civile (A8)

### Përmbajtja e hartës:

Për secilin fshat janë përpiluar të dhënat për instalimin e objekteve të përkujdesjes shëndetësore, qendrat ambulatorore<sup>5</sup>, barnatorët dhe shërbimet ambulatorë si dhe zonat përmbledhëse për objektet mjekësore.

| QKMF Dragash / GPMC Dragaš                                       |        |   |        |
|--|--------|---|--------|
| Stafi / Osoblje  |        |   |        |
| Mjek i përgjithshëm / Opšti lekar                                | 3      | Infermier / Medicinska sestra   | 13     |
| Mjek specialist / Lekar specijalista                             | 5      | Mami / Babica   | 4      |
| Stomatolog / Stomatolog  | 2      | Staf tjetër shëndetësor / Drugo zdravstveno osoblje                     | 10     |
| Shërbimet e ofruara në 2011 / Pružene usluge u 2011              |        |   |        |
| Shërbime të përgjithshme shëndetësore / Opšte zdravstvene usluge | 16.695 | Shërbime specialitike shëndetësore / Specijalističke zdravstvene usluge | 23.501 |
| Banorë të shërbyer / Usluženi stanovnici                         |        |   |        |
| AMF Funkcioni / APM Funkcija                                     | 6.643  | QMF Funkcioni / CPM Funkcija  | 8.261  |
|  |        | QKMF Funkcioni / GCPM Funkcija  | 42.171 |

Për secilin fshat vlerësimi tregon me të gjelbër, nëse stafi në dispozicion është sipas standardeve kombëtare (me të kuqe, nëse është nën standard) (shih tabelën në të majtë).

Shërbimet e sjellura në vitin 2011 si dhe banorët e shërbyer gjithashtu janë të indikuar.

### Porositë kryesore:

Kjo strukturë e shërbimeve shëndetësore mbetet një dobësi. Komuna e Dragashit ka një Qendër kryesore të Mjekësisë Familjare (në qytetin e Dragashit, e cila ofron asistencë 24 orëshe), pesë qendra për Mjekësi Familjare dhe tetë Klinika Shëndetësore.

Kriteri kombëtar për të themeluar dhe pajisur me personel një Qendër të Mjekësisë Familjare apo Klinikë Shëndetësore është si më poshtë:

- 1 Klinikë Shëndetësore për 6000 banorë (QKMF)
- 1 Qendër e Mjekësisë Familjare për 10.000 banorë (QMF)
- 1 Qendër Kryesore Mjekësore për 100.000 banorë (AMF)
- 1 Mjek dhe 2 motra për 2000 banorë

Në përgjithësi mund të deklarohet se: Numri i motrave (kryeinfermiereve dhe motrave të kombinuara - 36) tejkalon kërkesat minimale për numrin e popullatës në Dragash, por numri i doktorëve, dentistëve, gjinekologëve, apo mamive nuk përmbush standardet minimale. Në Restelicë me popullsi prej 4.698 banorëve, nuk ka Qendër të Mjekësisë Familjare (QMF), prandaj banorët duhet të shkojnë në Krushevë.

Tabela 1-15: Modeli me furnizimin me staf dhe deficitet në shërbimet mjekësore

| Fusha  | Numri i të punësuarve në Dragash | Kërkesat kombëtare për stafin: 1 për numër të banorëve | Minimumi i kërkuar i stafit për Dragashin (popullata 34000) |
|--|----------------------------------|--|---|
| Doktor(1 vesh, hundë & fyt doktor; 9 pa specializim) | 14                               | 2000   | 17  |
| Kryeinfermierë                                       | 5                                | (i kombinuar me numrin për motrat)                     |   |
| Motra  | 31                               | 1000   | 34  |
| Pediatër   | 1                                |  |   |
| Gjinekolog   | 0                                | 10.000   | 3   |
| Mami   | 0                                | 5000   | 7   |
| Raiolog  | 1                                |  |   |
| Teknik dental  | 4                                | 5000   | 7   |
| Teknik laborator                                     | 6                                |  |   |
| Farmacist  | 4                                |  |   |
| TOTALI   | 66                               |  |   |

<sup>5</sup> Qendër ambulatorë është përdorur në lidhje me kuptimin e saj si një ndërtesë që siguron shërbime themelore shëndetësore.





Për shkak të kufizimeve buxhetore jo të gjitha fshatrat kanë qendra mjekësore. Sidoqoftë një ushtrim zonimi është ushtruar për të kryer verifikimin e shërbimeve dispozitave të shërbimit (shih

Tabela1-16).

## Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Dragash, Drejtoria e Shëndetësisë, Maj 2012

Tabela1-16: Frekuentimet për shërbime mjekësore

| Fshati             | Lloji i qendrës mjekësore    | Fshatrat frekuentuese |
|--------------------|------------------------------|-----------------------|
| Dragash            | Qendra Mjekësore Kryesore    | Shajne                |
|                    |                              | Rrenc                 |
|                    |                              | Xërxe                 |
|                    |                              | Pllajnik              |
|                    |                              | Lubovishtë            |
|                    | Kukulanë                     |                       |
| Vranisht           | Qendër Ambulatore            | Mlikë                 |
|                    |                              | Orçushë               |
| Radeshë            | Qendër Ambulatore            | Leshtan               |
| Bresanë            | Qendër e Mjekësisë Familjare | Kuklibeg              |
| Kuk                | Qendër Ambulatore            | -                     |
| Kosavë             | Qendër Ambulatore            | Buzez                 |
| Blaç               | Qendër Ambulatore            | Zaplluxhe             |
|                    |                              | Zgatar                |
| Bellobrad          | Qendër e Mjekësisë Familjare | Kapre                 |
|                    |                              | Brrut                 |
|                    |                              | Zym                   |
| Llopushnik(Brezne) | Qendër e Mjekësisë Familjare | Buçe                  |
|                    |                              | Brezne                |
|                    |                              | Pllavë                |
| Rapçë              | Qendër e Mjekësisë Familjare | Kërstec               |
| Brod               | Qendër Ambulatore            | Dikance               |
|                    |                              | Baçkë                 |
| Krushevë           | Qendër e Mjekësisë Familjare | Zlipotok              |
| Gllloboçicë        | Qendër Ambulatore            | -                     |
| Restelicë          | Qendër Ambulatore            | -                     |



## 1.9. Vlerësimi i arsimit (A9)

### Përmbajtja e hartës:

| Llapushnik / Lopusnik   |                | banorë / stanovnici   |         |
|---|----------------|---|---------|
| Shkolla / Škola   | Shaban Shabani | Sistemi i Kosovës/Sistem Kosova                                 | Central |
| Nr i banorëve të shërbyer nga shkolla qendrore/Br stanovnika ushujenih od centralne škole               |                | 5.528   |         |
| Grupmoshat, numri i nxënësve dhe i mësuesve / Starosne grupe, broj učenika i učitelja                   |                |   |         |
| Nr i grupeve parashkollore/ Br predškolskih grupa   | 0              | Nr i fëmijëve parashkollor/ Br predškolske dece                 | 0       |
| K 1-5   |                | Nr i nxënësve / Br učenika                                      | 226     |
| K 6-9   | X              | Nr i nxënësve meshkuj / Br učenika muško                        | 125     |
| K 10-13   |                | Nr i nxënësve femra / Broj učenika žensko                       | 101     |
| S 1-4   |                | Nr i mësuesve / Br učitelja                                     | 0       |
| S 1-8   |                | Nr i klasave / Br učionica                                      | 7       |
| S 9-12  |                | Total m <sup>2</sup> i klasave / Ukupno m <sup>2</sup> učionica | 830     |
| Vlerësimi i raportit infrastrukturë dhe nxënës-mësues / Procena odnosa infrastrukture i učenici-učitelj |                |   |         |
| Gjendja e përgjithshme e ndërtesës / Opšte stanje zgrade  | Mirë / Dobro   | m <sup>2</sup> për nxënës / m <sup>2</sup> po učeniku           | 0,0     |
| Klasë për një grupmoshë / Učionica po starosnoj grupi   | 0,8            | m <sup>2</sup> për nxënës / m <sup>2</sup> po učeniku           | 3,7     |
| Koherencë me kuptim funksional të vendbanimit / Koherentnost sa funkcionalnim smislom naselja           |                | PO / DA   |         |

Për secilin fshat, numri i nxënësve (meshkuj dhe femra), klasat e tyre sipas vjetëve për sistemin e Kosovës (K) dhe sistemin Serb (S), mësuesit, klasat dhe madhësia janë të përfshira në tabelën e vlerësimit (shih figurën në të majtë si shembull).

Për secilin fshat tabela tregon më të gjelbër, nëse standardet kombëtare plotësohen (me të kuqe, nëse është mbi apo nën standardin) dhe të verdhë nëse numri është kritik.

Kategoria e shkollës sipas Komunës është “Shkollë Qendrore (1-8) 9<sup>o</sup> klasë”, “Shkollë Satelit (1-(4) 5 klasë)” dhe “Shkollë e Lartë (shkollë e mesme)”.

**Koherenca:** Vendbanimet urbane janë kasifikuar sipas funksionit në komunë–Vendbanim qendror, fshat nën-qendror, fshat dhe fshat i thellë (ju lutemi të i referoheni Figura 1-30). Një “Qënder” duhet të ketë secilën kategori të shkollës, një “nën-qënder” së paku një shkollë qendrore, “fshatrat” dhe “fshatrat e thella” së paku një shkollë satelit.

### Porositë kryesore:

**Numri i shkollave në komunën e Dragashit:** 39- 27 janë të themeluara nga institucionet Kosovare, 9 nga institucionet Serbe, dhe 3 pranojnë fonde të pjeshme nga Kosova dhe Serbia.

**Koherenca:** Vetëm në Brezne dhe Mlikë kategoria e shkollës nuk përkon me funksionin hapësinor të fshatit.

**Stafi** që punon në fushën e arsimit. Janë rreth 500 punëtorë të cilët janë të punësuar nga komuna.

**Raporti Mësues/nxënës:** Kërkesat kombëtare tregojnë minimumin prej 10 mësuesve dhe maksimumin prej 35 nxënësve për mësues. Janë 7 fshatra të cilat kanë raport më të madh student / mësues (mbi20). 2 fshatra në Opojë kanë një numër të vogël të nxënësve me më pak se 10 (Xërxe and Zym) dhe 10 fshatra të Gorës (Baçkë, Kërstec, Krushevë, Kukulanë, Leshtane, Lubovishtë, Radeshë, Rapçë, Restelicë, Vranisht). 70% e fshatrave (8 nga 12) me raport të ulët janë në territoret që janë duke përjetuar ulje neto të popullsisë që nuk reflektojnë me ulje në numër të stafit. 2 fshatra janë stabile me numër të popullatës, por kanë raport të ulët nxënës/mësues.

**Sipërfaqja:** Standardet kombëtare kërkojnë 2.5m<sup>2</sup> sipërfaqe për nxënës. Të gjitha shkollat në Dragash e tejkalojnë këtë kërkesë.

**Gjendja e ndërtesave:** 8 nga shkollat (në fshatrat Baçkë, Bellobrad, Dikance, Orçushë, Mlikë, Xërxe dhe Vranisht) janë gjykuar të kenë kushte të varfëra në sondazhin në teren të UNDP (struktura e ndërtesës (muret, dyshemetë, dritaret, dyert) si dhe mablet (tavolinat, karriget, dërrasat e zeza)).

**Numri i klasave për grup sipas vjetëve** (nëse ka 0 deri 0,5 klasë për një grup atëherë mund të deklarohet deficit, deficit i vogël mund të deklarohet nëse ka 0,6 – 0,9 klasa dhe nëse ka më shumë se 1 atëherë nuk ka deficit.

### Burimet e të dhënave, materiali dhe siguria:

Republika e Kosovës (2008): Ligji Nr. 03/L-040 për Vetë-Qeverisjen Lokale, Republika e Kosovës (2011): Ligji për Edukimin Para-Universitar No.04/L-032, informata personale, Drejtori i Edukimit 2012.

<sup>6</sup>Sistemi Serb nga 1-4 apo 8, Sistemi Shqipëtar 1-5 apo 9




# Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm për Dragashin – Kosovë



Figura1-29: Vlerësimi i arsimit (A9)



### 1.10. Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës, dhe energjisë (A10)

Funksionet e themelimit të reflektuar janë të bazuara në dy inpute:

1. Klasifikimi sipas popullacionit të tyre rezident dhe
2. Ekzistenca e tyre si dhe funksioni potencial për komunën.




Figura 1-30: Funksionet e vendbanimeve (Shif Tabela 1-17)

#### Klasifikimi sipas popullacionit të tyre rezident:

Katër qendrat primare janë Dragashi, Brezna, Restelica dhe Bresana. Ato përbajnë numër të madh të komoditeteve, ndërmjet 53 – 71 dyqaneve.

Dymbëdhjet vendbanimet dytësore me popullacion ndërmjet 1000 dhe 3500 janë Bellobrada, Blaçi Brodi, Brruti, Buçja, Kosava, Kuki, Kuklibegu, Pllajniku, Shajna, Zaplluxha, dhe Zgatari. Ato janë të karakterizuara me një numër të bizneseve të vogla dhe të mesme, me fshatra që përbajnë ndërmjet 4 dhe 30 ndërmarrje.

Janë njëzet qendra terciare, me popullacion prej më pak se 1000 banorë. Popullata e shumicës së këtyre fshatrave është në zvoglim sa që fshati paraqitet i 'braktisur' gjatë pothuajse tërë vitit. Ka probleme të theksuara me rrjetet e komunikimit dhe infrastrukturës, në veqanti sa i përket menaxhimit të mbeturinave të ngurta. Gjashtë prej këtyre fshatrave gjithashtu janë klasifikuar si 'Fshatra të thella', me popullatë në zvogëlim e sipër dhe lokacione të largëta që e bëjnë qasjen më të vështirë.



## Klasifikimi sipas funksionit egzistues dhe potencial “Koncepti Qendër”:

Tabela 1-17: funksionet e zonave të urbanizuara në terme të konceptit qendër sipas infrastrukturës egzistuese dhe nevojat zhvillimore të tyre (funksioni i themelimit) k

| Emri i Vendbanimit | Klasifikimi sipas madhësisë | Klasifikimi funksional (koncepti qendër) | Zona  |
|--------------------|-----------------------------|--|-------|
| Dragash            | Vendbanim sekondar          | Qendër                                   | MIX   |
| Bellobrad          | Vendbanim dytësor           | Nën - Qendër                             | OPOJA |
| Blaç               | Vendbanim dytësor           | Nën - Qendër                             | OPOJA |
| Brezne             | Qendër primare              | Nën - Qendër                             | OPOJA |
| Brod               | Vendbanim dytësor           | Nën - Qendër                             | GORA  |
| Bresanë            | Qendër Primare              | Nën - Qendër                             | OPOJA |
| Rapçë              | Vendbanim sekondar          | Nën - Qendër                             | GORA  |
| Restelicë          | Qendër Primare              | Nën - Qendër                             | GORA  |
| Brrut              | Vendbanim dytësor           | Fshat                                    | OPOJA |
| Buçe               | Qendër terciare             | Fshat                                    | OPOJA |
| Buzez              | Qendër Terciare             | Fshat                                    | OPOJA |
| Gllloboçicë        | Vendbanim sekondar          | Fshat                                    | GORA  |
| Kapre              | Qendër Terciare             | Fshat                                    | OPOJA |
| Kosavë             | Vendbanim dytësor           | Fshat                                    | OPOJA |
| Kërstec            | Qendër Terciare             | Fshat                                    | GORA  |
| Krushevë           | Vendbanim sekondar          | Fshat                                    | GORA  |
| Kuk                | Vendbanim dytësor           | Fshat                                    | OPOJA |
| Kuklibeg           | Vendbanim dytësor           | Fshat                                    | OPOJA |
| Kukulanë           | Qendër Terciare             | Fshat                                    | GORA  |
| Lubovishtë         | Qendër Terciare             | Fshat                                    | GORA  |
| Mlikë              | Qendër Terciare             | Fshat                                    | GORA  |
| Pllavë             | Vendbanim sekondar          | Fshat                                    | OPOJA |
| Pllajnik           | Qendër terciare             | Fshat                                    | OPOJA |
| Radeshë            | Qendër Terciare             | Fshat                                    | GORA  |
| Rrenc              | Qendër Terciare             | Fshat                                    | OPOJA |
| Shajne             | Vendbanim dytësor           | Fshat                                    | OPOJA |
| Vranisht           | Qendër Terciare             | Fshat                                    | GORA  |
| Zaplluxhe          | Vendbanim dytësor           | Fshat                                    | OPOJA |
| Zgatar             | Vendbanim dytësor           | Fshat                                    | OPOJA |
| Zym                | Qendër Terciare             | Fshat                                    | OPOJA |
| Baçkë              | Fshat i thellë              | Fshat i thellë                           | GORA  |
| Dikanc             | Fshat i thellë              | Fshat i thellë                           | GORA  |
| Leshtane           | Fshat i thellë              | Fshat i thellë                           | GORA  |
| Orçushë            | Fshat i thellë              | Fshat i thellë                           | GORA  |
| Xërxe / Zrze       | Fshat i thellë              | Fshat i thellë                           | OPOJA |





| Emri i Vendbanimit  | Klasifikimi sipas madhësisë | Klasifikimi funksional (koncepti qendër) | Zona |
|---------------------|-----------------------------|--|------|
| Zlipotok / Zlipotok | Fshat i thellë              | Fshat i thellë                           | GORA |

## 1.10.1. Rrugët dhe Transporti (A10.1)

### Konceptet e hartës:

Rrjeti transportues ekzistues

- Rrugë regionale dhe lokale (dhe mbulimi i rrugëve)
- Rrugët pyjore dhe bujqësore
- Rrugica të mëdha këmbësorësh

Ngushticat në rrjetin e rrugëve egzistuese (rrugicat e ngushta te fshatit)

Projektet e propozuara (komunale) për konstruksion / përmirësim të rrugëve

- Vlerësimi i AZHQ për realizim të qëndrueshëm (i rekomanduar, i rekomanduar për fizibilitet dhe vlerësim të kostos, jo i rekomanduar)

Stacionet kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë

Transporti Publik

- Linja të autobusit dhe transport privat (brenda zonave të arritshme)

### Mesazhet Kryesore:

#### Rrugët:

Kufizimet natyrore sa i përket lidhjeve rrugore nëpër male kanë qenë gjithnjë arsyeja se pse Dragashi ka mbetur largët.

Janë diku 570 km rrugë dhe rrugica brenda për brenda komunës së Dragashit , dhe nga këto përafërsisht gjysma (278 km) janë të qasshme për makina të zakonshme. Këto ndryshojnë shumë në kualitet. Për momentin, vetëm Orçushë dhe Pllajniku nuk kanë qasje me rrugë të asfaltuar. Disa rrugë ndërmjet fshatrave dhe brenda fshatit gjithashtu janë të paasfaltuara. Komuna e Dragashit është e lidhur me pjesën tjetër të Kosovës me vetëm një rrugë të asfaltuar, e cila lidhet direkt me autostradën ndërmjet Shqipërisë dhe Prishtinës dhe një rrugë me zhavor afër Zaplluxhes. Një rrugë me zhavor nga Restelica te qon në drejtim të kufirit jugor, e cila lidhet me Dragashin, tek regjioni I Gorna Reka me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në pikën në Malin e Lukovo Pole (1500m). Rrugica të tjera bujqësore dhe rrugica këmbësorësh shtrihen përgjatë kufijve informal me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërinë.

**Tabela 1-18** Lista e projekteve rrugore të paraqitura ne hartën A10. duke përfshirë detajet e rëndësishme dhe rezultatet e vlerësimit preliminar.

Tabela 1-18: Projektet rrugore të propozuara dhe vlerësuara

| Lartësia mbidetare | Gjatësia | Vlera e shtuar | Harxhi met | Mospajtim Parku Kombëtar | Mospajtim biodiversitet | Vlerësimi final | Rekomandim    | Prioritet |
|--------------------|----------|----------------|------------|--------------------------|-------------------------|-----------------|---------------|-----------|
| 920-1020           | 11,844   | 1              | 3          | 1                        | 3                       | 2               | realizo       | X         |
| 1170-1250          | 2,524    | 2              | 2          | 1                        | 3                       | 2               | realizo       | X         |
| 1140-1405          | 3,226    | 1              | 2          | 3                        | 3                       | 2               | realizo       | X         |
| 1050-1100          | 449      | 4              | 2          | 1                        | 1                       | 2               | realizo       |           |
| 1144-1150          | 1,948    | 4              | 1          | 1                        | 1                       | 2               | realizo       |           |
| 1280-1360          | 2,497    | 3              | 2          | 1                        | 2                       | 2               | realizo       |           |
| 950-1120           | 3,174    | 2              | 3          | 2                        | 3                       | 2               | realizo       |           |
| 1020-1380          | 12,420   | 2              | 2          | 2                        | 3                       | 2               | realizo       |           |
| 1440-1900          | 16,705   | 1              | 4          | 4                        | 5                       | 3               | verifiko      | X         |
| 1380-1480          | 6,978    | 2              | 3          | 3                        | 4                       | 3               | verifiko      |           |
| 1400-1920          | 12,463   | 2              | 4          | 4                        | 5                       | 3               | verifiko      |           |
| 800-850            | 5,136    | 3              | 4          | 3                        | 4                       | 3               | verifiko      |           |
| 1350-1400          | 950      | 3              | 5          | 2                        | 2                       | 3               | verifiko      |           |
| 1200-1520          | 11,090   | 2              | 3          | 3                        | 4                       | 3               | verifiko      |           |
| 1160-2470          | 11,650   | 4              | 4          | 5                        | 5                       | 4               | largo         |           |
| 1420-2200          | 12,744   | 4              | 3          | 4                        | 4                       | 4               | largo         |           |
| 1400-1940          | 23,055   | 5              | 5          | 5                        | 5                       | 5               | largo         |           |
|                    | 1        | shumë e lartë  |            | shumë i ultë             |                         |                 | shumë e lartë |           |
|                    | 2        | e lartë        |            | i ultë                   |                         |                 | e lartë       |           |
|                    | 3        | mesatar        |            | mesatar                  |                         |                 | mesatar       |           |
|                    | 4        | i ultë         |            | e lartë                  |                         |                 | i ultë        |           |
|                    | 5        | shumë i ultë   |            | shumë e lartë            |                         |                 | shumë i ultë  |           |

### Transporti Publiko/privat:

